



Ky projekt
financohet nga
Bashkimi Evropian



bashkëpunimi
gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by

giz
GIZ - Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit



Ky event mbështetet nga
Bashkëpunim Gjerman, nëpërmjet GIZ

albanian
rural
parliament

parlamenti
rural
shqiptar

Participatory
democracy

Demokraci
pjesëmarrëse



DOKUMENT **PËRMBLEDHËS**

© Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural. 2021

Ky dokument u përgatit në kuadër të projektit 'Mbledhja e Parlamentit të Dytë Rural Shqiptar: Perspektiva evropiane e Shqipërisë rurale' i zbatuar nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural dhe mbështetur nga projekti Zhvillimi i Qëndrueshëm Rural, financuar nga Bashkëpunimi Gjerman nëpërmjet GIZ. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ.

Përmblodhën dhe redaktuan:

Evelina Azizaj
Lorena Ttoni
Desjana Grymshi

Dizajni dhe faqosja:

Eduart Cani



Mirënjohje

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural shpreh mirënjohjen për mbështetësit, kontribuesit dhe pjesëmarrësit e këtij takimi të rëndësishëm të sektorit bujqësor dhe rural.

Faleminderit njëzet e tetë organizatave anëtare të Rrjetit Shqiptar të Zhvillimit Rural pa kontributet e të cilave organizimi i Parlamentit do të ishte një sfidë reale. Faleminderit të gjithë mbështetësve të kauzës së zhvillimit rural dhe nismave të ANRD për kontributin e tyre në organizimin e qelizave virtuale komunitare në mbarë Shqipërinë.

Një falënderim i veçantë i shkon Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe stafit akademik për mbështetjen e vazhdueshme në realizimin e platformës së Parlamentit rural shqiptar si dhe Universitetit Epoka për dashamirësinë e treguar për të mirëpritur organizimin e Parlamentit në një format të pazakontë përmes ofrimit të infrastrukturës digjitale.

ANRD falenderon në mënyrë të veçantë Bashkimin Evropian si donatorin kryesor të zhvillimit dhe konsolidimit të Rrjetit si dhe i nismave advokuese sikurse është Parlamenti kombëtar rural. Faleminderit edhe Bashkëpunimit Gjerman që përmes mbështetjes dhe asistencës së projektit Zhvillimi i Qëndrueshëm Rural i zbatuar nga GIZ dha kontribut të rëndësishëm në këtë ngjarje të rëndësishme kombëtare për sektorin.



Rreth Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD) përfaqëson një nismë genuine të shoqërisë civile që kontribuon për zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve rurale, duke marrë një rol aktiv në proceset reformuese të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, veçanërisht në përafrimin me politikën evropiane të Zhvillimit Vendor të Udhëhequr nga Komuniteti (CLLD). Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural promovon advokacinë me orientim nga poshtë-lart dhe zbaton një qasje gjithëpërfshirëse për politika efektive rurale që janë më pranë banorëve të komuniteteve rurale, hartuar me pjesëmarrjen e komuniteteve vendore, kuptuar dhe zbatuar me njerëzit në territor.

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural u formalizua më 11 dhjetor 2015 duke kurorëzuar një seri përpjekjesh ndër vite për të avancuar rolin e sektorit jo-publik në agjendën e zhvillimit rural të vendit tonë. ANRD është organizatë me anëtarësi, e themeluar nga katërmbëdhjetë organizata nismëtare dhe, aktualisht numëron njëzet e tetë organizata anëtare, të cilat kanë përvojë të gjatë dhe të konsoliduar në tematika të ndryshme të zhvillimit rural dhe me shpërndarje të ndryshme gjeografike në gjithë territorin e vendit tonë.

Përpjekjet e deritanishme kanë reflektuar gatishmërinë për të mbështetur dhe kontribuar në zbatimin me sukses të politikave dhe instrumenteve të zhvillimit të qëndrueshëm rural. Rrjeti ka zbatuar një seri nismash në ndërtimin e kapaciteteve, rrjetëzimin dhe advokacinë nga poshtë të cilat kanë nxitur entuziazmin dhe kanë gjeneruar interes dhe besim te aktorët vendor. Për këtë, Rrjeti ka rritur angazhimin e vet në proceset reformuese të sektorit për të ofruar një fokus të unifikuar në shprehjen e interesave dhe prioritetëve të komuniteteve rurale, për t'u lidhur me qeverisjen dhe për të influencuar politikën dhe veprimet e institucioneve publike dhe aktorëve të tjerë të interesit në ndihmë të ekonomisë dhe jetës në fshat.

Për më shumë informacion rreth ANRD klikoni: www.anrd.al

Dy fjalë mbi Parlamentin Rural Shqiptar...

I promovuar si një model dhe projekt evropian para tri vitesh, Parlamenti Kombëtar Rural në Shqipëri mbetet një projekt me fokus sa mirëqeverisjen po aq dhe demokracinë gjithëpërfshirëse.

Parlamenti Rural Shqiptar është pjesë e Parlamentit Rural Evropian – lëvizje mbarëevropiane që kërkon të shprehë zërin e komuniteteve rurale, të artikulojë shqetësimet e njerëzve në zonat rurale si dhe të promovojë veprimet e ndërmarra nga banorët e zonave rurale në partneritet me shoqërinë civile dhe qeverisjen. Ngjashën me rrjetet rurale evropiane, ANRD është angazhuar në organizimin e Parlamentit Rural Shqiptar për të sjellë së bashku njerëzit nga gjithë zonat rurale për të diskutuar sfidat dhe veprimet konkrete që duhet të ndërmerren, ose për të influencuar qeverisjen dhe aktorë të tjerë zhvillimorë për të përmirësuar mirëqënien e banorëve të zonave rurale.

Parlamenti Rural Shqiptar përfaqëson një platformë advokacie, ndërtimi të kapaciteteve dhe rrjetëzimit dedikuar zhvillimit rural. Kjo platformë ka një rëndësi të madhe duke qenë të ndërgjegjshëm që përpjekjet e aktorëve të ndryshëm për të përmirësuar cilësinë e jetës rurale, duhet të mbështeten mbi nevojën e qartë për advokaci më të fortë në lidhje me politika publike të përmirësuar dhe efektive.

Parlamenti i dytë rural shqiptar – një përpjekje e përbashkët e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural me anëtarësi prej njëzet e tetë OSHC lokale në koordinim me Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Universitetin Epoka – solli së bashku më 4-5 mars 2021, fizikisht dhe në distancë, njerëz nga komunitetet të ndryshme rurale dhe aktorë të rëndësishëm të zhvillimit bujqësor dhe rural për të diskutuar sfidat dhe veprimet konkrete që duhet të ndërmerren për mirëqënien e banorëve të zonave rurale. Parlamenti i dytë rural shqiptar krijoi atmosferën e duhur dhe shënoi një moment të rëndësishëm për dialog, bashkëpunim, shkëmbim dhe, diskutim të çështjeve me rëndësi për zhvillimin rural si dhe për të ofruar rekomandime për zhvillimin dhe rigjallërimin e jetës dhe ekonomisë së komuniteteve rurale.

PARLAMENTI I DYTË RURAL SHQIPTAR SHËNOI NJË PIKË KULMORE

DITA E PARË E PARLAMENTIT TË DYTË RURAL SHQIPTAR
4 MARS 2021

1

- **gjashtë fjalë përshëndetëse** nga përfaqësues të lartë të organizatorëve dhe mbështetësve
- **tre raste nga realitete rurale** aktuale që shërbyen si shkëndija për debatin plenar
- **tetë panelistë** në debatin plenar
- **dy raunde të workshopeve paralele**
- **8 workshope** – tetë çështje aktuale dhe relevante të zhvillimit rural u eksploruan nga perspektiva të shumta të aktorëve të interesit
- **24 ekspertë të angazhuar**, tre për secilin workshop (moderator, folës kryesor dhe raportues)



MË SHUMË SE 600 PJESËMARRËS, NË PREZENCË DHE
DISTANCË, DUKE RESPEKTUAR RREGULLAT E PANDEMISË



60 QELIZA KOMUNITARE – VEND TAKIM I DERI 10 PËRFAQËSUESVE
TË AKTORËVE VENDOR QË MORËN PJESË VIRTUALISHT NË DY DITËT
E PARLAMENTIT TË DYTË RURAL SHQIPTAR

TË ADVOKACISË RURALE, RRJETËZIMIT DHE SHKËMBIMIT.

DITA E DYTË E PARLAMENTIT TË DYTË RURAL SHQIPTAR 5 MARS 2021

- **3 fjalë përshëndetëse** dhe ndërhyrje nga mbështetës dhe miq të parlamentit rural
- **dy sesione plenare**
- **konkluzionet nga kuvendimi në kafënë rurale:** prezantimi rezultateve të diskutimeve sipas tematikave
- sesion Plenar: **Të rinjtë në zonat rurale në udhëkryq**
- **dy grupe me nga pesë të rinj:** nga Qendra Burimore e të rinjve ruralë dhe Universiteti i Tiranës
- **dy mentorë për përgatitjen e të rinjve** në debat
- **pesë përfaqësues të lartë** të institucioneve publike dhe jo-publike ofruan reagime dhe komente mbi debatin e të rinjve
- një sesion përmbyllës: **Leximi dhe aprovimi i Deklaratës së përbashkët**

2

NJË KONFERENCË PËR SHTYP MË 3 MARS 2021 E ORGANIZUAR ONLINE ME PJESËMARRJEN E PËRFAQËSUESVE TË MEDIAS DHE TRE PËRFAQËSUESVE TË LARTË TË ORGANIZATORËVE TË PARLAMENTIT TË DYTË RURAL SHQIPTAR – RRJETI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN RURAL, UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS DHE UNIVERSITETI EPOKA • TRANSMETIM ONLINE I DY DITËVE TË PARLAMENTIT NË FAQEN ZYRTARE TË FACEBOOK TË ANRD • MË SHUMË SE 150 PERSONA TË RREGISTRUAR NË PLATFORMËN ZOOM • **100 LIDHJE NË PLATFORMËN ZOOM** • TRE INTERVISTA TELEVIZIVE TË STAFIT TË ANRD MBI PARLAMENTIN • **MË SHUMË SE 18.000 REACH NË FAQEN ZYRTARE TË FACEBOOK TË ANRD** • PUBLIKIMI I BOOKLET TË PARLAMENTIT RURAL SHQIPTAR • PUBLIKIMI I DEKLARATËS SË PËRBASHKËT • PUBLIKIM ONLINE I KËTIJ DOKUMENTI PËRMBLEDHËS



ÇELJA E PARLAMENTIT TË DYTË RURAL SHQIPTAR MIRËSEARDHJE

Fjalët përshëndetëse nga organizatorët dhe mbështetësit

■ ***Evelina Azizaj, Koordinatore Kombëtare, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural***

Në çeljen e Parlamentit të dytë rural shqiptar, Zj. Azizaj shprehu entuziazmin për organizimin e këtij aktiviteti të rëndësishëm për gjithë fermerët, banorët dhe aktorët e interesit të zhvillimit rural pavarësisht situatës pandemike. Përdorimi i inovacionit digjital në adresimin e sfidës së komunikimit dhe ndërveprimit në kohë të tilla të pazakonta mundësoi realizimin e këtij takimi të madh të aktorëve të ndryshëm të interesit.

Në vazhdim të fjalës së saj, zj. Azizaj e vlerësoi çështjen e zhvillimit rural një çështje të madhe kombëtare dhe të mirë publike. Lidhja e secilit prej nesh me një zonë rurale për shkak të rrënjëve familjare, reforma e pambaruar bujqësore, eksodi i vazhdueshëm, zhvillimi i agriturizmit, pejzazhi rural, siguria ushqimore aq shumë e diskutueshme në kohën e Covid-it e të tjera e bëjnë zhvillimin rural një çështje të madhe kombëtare. Dhe si e tillë kjo kërkon instrumente dhe alternativa për t'u lidhur, diskutuar dhe dëgjuar njëri-tjetrin si dhe për të kërkuar vëmendje e mbështetje për jetën dhe ekonominë rurale.

Shkurtimisht, zj. Azizaj tregoi rrugëtimin nga Parlamenti i parë rural shqiptar në të dytin, i cili ka përfshirë përpjekje të vazhdueshme për të animuar dialogun dhe kontributin e aktorëve të ndryshëm publik dhe jo-publik dhe për të përmbyllur advokacinë kombëtare rurale në këtë parlament të dytë.

“Jemi mbledhur për të diskutuar sfidat dhe veprimet konkrete që duhet të ndërmerren për të përmirësuar mirëqënien e banorëve të zonave rurale. Parlamenti i dytë konfirmon përpjekjet e aktorëve për ta kthyer atë [platformën e Parlamentit] në një kuadër rregullator kombëtar për zhvillimin rural dhe bujqësor me synimin për të nxitur dhe mbajtur të qëndrueshëm dialogun kombëtar mbi qeverisjen e sektorit. Ky dialog kombëtar është i rëndësishëm për të shqyrtuar realitetin dhe njohur më mirë me nevojat dhe problematikat, për të reflektuar rreth vizionit dhe prioritetëve për të përmirësuar komunitet rurale anembanë vendit”.

Güngör Turan, Rektor, Universiteti Epoka

Z. Turan fillimisht vlerësoi platformën e parlamentit rural si një përpjekje për të arritur të gjithë aktorët e interesit për të avancuar zërin e tyre në vendimarrje. Kontributi i gjithë aktorëve të interesit në rivitalizimin e zonave rurale është i rëndësishëm për të sjellë ndryshime pozitive theksoi z. Turan.

“Ne [Universiteti Epoka] jemi të kënaqur të marrim pjesë në këtë event, qëllimi i të cilit është në linjë me misionin tonë si një institucion i arsimit të lartë për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë bazuar në nevoja dhe sfida kombëtare”.

z. Turan solli në vëmendje të pjesëmarrësve përfshirjen dhe kontributin e Universitetit Epoka përmes Departamentit të Arkitekturës në programin e 100 fshatrave, i cili u inicua nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Gjithashtu, nisur nga situata pandemike Universiteti Epoka ka mundur kalimin e suksesshëm të mësimin online për studentët e Universitetit Epoka gjë që është bërë i mundur përmes instalimit të infrastrukturës hy-flex në të gjitha klasat dhe auditoret.

z. Turan përfundoi fjalën e vet: *“Unë besoj se eventi [Parlamenti] do të kontribuojë në përmirësimin e përfshirjes së agjendës së zhvillimit rural në politikat kombëtare. Gjithashtu, kjo platformë është një kontribut për përmirësimin e demokracisë dhe vendimarrjes me pjesëmarrje. Në fund, dëshiroj të theksoj gatishmërinë e Univesitetit Epoka për të kontribuar me ekspertizë përmes stafit akademik dhe studentëve”.*

Fatbardh Sallaku, Rektor, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Fjala e z. Sallaku evidentoi rritjen e pjesëmarrjes dhe mbështetjes që ka gjeneruar platforma e Parlamentit Rural, që fokusohet në zhvillimet e një ndër sektorëve kryesore të ekonomisë shqiptare. Sipas fjalës së z. Sallaku kjo pjesëmarrje e rritur dhe përfaqësuese e grupeve dhe shoqatave

të ndryshme që punojnë në zonën rurale, dëshmon faktin që ANRD ka ndërtuar dhe formësuar identitetin e vet në sistemin e politikave dhe qeverisjes në sektorin rural.

Z. Sallaku nënvizoi rëndësinë ekonomike të sektorit bujqësor në Shqipëri dhe nevojën për vëmendje, veçanërisht në drejtim të shtimit të potencialeve prodhuese dhe të rritjes së efikasitetit të përdorimit të tyre. Gjithashtu, në fjalën e vet, Rektori solli edhe shqetësimet të cilat jepen përmbledhtas si më poshtë:

- Ligjërata politike dhe politikat e zhvillimit në nivel kombëtar dhe evropian dominohen nga mendimi dhe perspektiva urbane duke lënë të harruara zonat e largëta, fshatrat, bashkitë dhe qytetet e vogla, pavarësisht se këto përfaqësojnë hapësira të ndërveprimit ekonomik, social, kulturor midis njerëzve, sipërmarrësve dhe administratës lokale.
- Mungesa e vëmendjes ndaj zonave rurale ka nxitur një spirale rënie që ka shkaktuar një eksod të njerëzve. Si rrjedhim ka më pak shërbime, papunësi, varfëri, izolim dhe zhvlerësim të pronës;
- Distanca midis politikanëve, vendimmarrësve dhe aktorëve ruralë është e dukshme në politikë, në veprime dhe komunikim;
- Potenciali i zhvillimit dhe vlera e shtuar ekonomike e siguruar nga njerëzit dhe burimet rurale ende nuk njihet plotësisht;
- Shkalla e ulët e absorbimit të mbështetjes financiare për investime të huaja dhe të brendshme mbetet pengesë kryesore e sektorit bujqësor;
- Pronësia mbi tokën (prona në përgjithësi) si një faktor që po bllokoi apo ngadalëson iniciativën për investime në bujqësi dhe veprimtari të tjera ekonomike të cilat kontribuojnë në zhvillimin e zonave rurale.
- Mungesa e informacionit, e njohurive dhe trajnimit profesional në lidhje me menaxhimin dhe administrimin e fermës, kërkesave të tregut, teknikave të reja të bujqësisë dhe teknologjive të përpunimit si dhe shumë çështje të tjera që shqetësojnë fermerët shqiptarë kanë dhe ende vazhdojnë të ndikojnë;

Prof. Sallaku adresoi pjesëmarrësit duke ndarë bindjen se Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Qeveria e konsiderojnë ANRD dhe Parlamentin Rural si faktorë partneriteti të gjerë dhe të hapur ndërmjet sektorit publik, privat dhe civil, dhe do ta përdorin këtë partneritet për të gjeneruar energji dhe burime pozitive në procesin e tyre zhvillimor. Ky

takim, si përfaqësues i interesave të sektorit privat, shoqërisë civile dhe qeverisjes vendore në sfidat e vendit për zhvillimin e qëndrueshëm rural, do të diskutojë dhe debatojë mbi çështje të ndryshme për t'i dhënë zë popullatës rurale, për të ndikuar politikën si dhe për të zhvilluar rrjete të reja në zonat rurale.

“Në këtë nismë [Parlamenti kombëtar rural] të nisur tre vjet më parë, unë dua t’ju siguroj që Universiteti Bujqësor është partneri juaj. Ne jemi gati të punojmë dhe mbështesim këtë forum të nderuar dhe mbi të gjitha të kontribuojmë drejtpërdrejt në përshpejtimin e procesit reformues të integritimit evropian të sektorit bujqësor dhe rural. Unë dua t’ju nxis këtu sot që nëpërmjet zërit tuaj të kërkoni përpjekje të përbashkëta nga të gjithë palët e interesuara për zhvillimin e zonave rurale, nga njerëzit, politikanët dhe vendimmarrësit për të ndaluar këtë spirale rënie, duke forcuar shërbimet rurale dhe duke mbështetur ekonomitë e larmishme rurale përmes projekteve të ndryshme si dhe decentralizimin e tyre. Zëri dhe avokimi juaj duhet të njihen dhe të jenë më të pranishëm në programimin dhe hulumtimin e politikave qeveritare në vend. Mesazhet dhe sugjerimet tuaja duhet që të përfshihen dhe reflektohen në politikat dhe programet kombëtare të zhvillimit rural, me qëllim arritjen e një qasje të ekuilibruar në të tre dimensionet e qëndrueshmërisë së zonave rurale - sociale, ekonomike dhe mjedisore”.

Z. Sallaku foli për rëndësinë e madhe të Universitetit Bujqësor të Tiranës për zhvillimin e sektorit bujqësor dhe rural në vend dhe kontributin në ekonominë e vendit. Për të luajtur këtë rol të rëndësishëm dhe në dobi të shoqërisë, UBT-ja ka ndryshuar konceptimin e vet të funksionimit për t’u shndërruar në një institucion të përsosmërisë: institucion për të cilin të gjithë njerëzit të ndjehen krenarë, studentët të dëshirojnë të studiojnë, dhe studiuesit dhe kerkuesit më të mirë të dëshirojnë të punojnë. Z. Sallaku me të drejtë preku çështjen e interesit gjithnjë e më të ulët të brezit të ri për të studiuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Ky realitet i hidhur ndodh në një kohë kur ka platforma si kjo e Parlamentit rural që diskutojnë sfidat aktuale, kur sektori bujqësor ka një rëndësi mjaft të madhe ekonomike, kur institucionet përgjegjëse si Ministria e Bujqësisë dhe zhvillimit Rural nëpërmjet Agjencisë së Zhvillimit Rural dhe Bujqësor kanë bërë progres në drejtim të thithjes së fondeve të BE-së, dhe për më tepër kur UBT ka filluar rishikimin dhe përshtatjen e programeve mësimore duke i përshtatur ato me kërkesat dhe fokusin e politikës së BE, duke përfshirë njohuri mbi ekonominë e gjelbër, përshtatjes me ndryshimet klimatike, mbrojtjen e biodiversitetit, rolin e pyjeve dhe peshkimit, etj.

Rektori theksoi rolin e rëndësishëm që luajnë kapacitetet njerëzore të sektorit në jetësimin e strategjive të sektorit, aq më tepër kur aktualisht Ministria ka inicuar procesin e planifikimit të Strategjisë për Bujqësinë,

Zhvillimin Rural dhe Peshkimin (2021-2027), e cila do të prezantojë konceptet dhe kërkesat e BE-së për sektorin dhe do të ofrojë një vizion se ku do të shkojë sektori bujqësor për 10 vitet e ardhme në Shqipëri. Dhe në këtë drejtim UBT është i vetmi në Shqipëri që siguron profesione të tilla si agronomi, zootekni, inxhinieri pyjesh, mbrojtje bimësh, hortikulturë, etj. Megjithatë, UBT po përballet me sfidën e numrit të ulët të studentëve të regjistruar në këto programe të cilat konsiderohen tradicionale për UBT dhe me rendësi jetike për ekonominë shqiptare. Të dhënat statistikore tregojnë që nëse ky trend vazhdon dhe kufiri hyrës aktual në Universitete (sipas notës mesatare të percaktuar me VKM) vazhdon të aplikohet programet e ofruara nga UBT të tilla si: Agronomi, Zootekni, Inxhinier Pyjesh, Mbrojtje Bimësh, Hortikulturë, Peshkim, Përpunim Druri do të ndikohen ndjeshëm dhe rrezikojnë mbylljen e tyre për shkak të mungesës së studentëve. Mbështetja e qeverisë shqiptare dhe e Ministrisë në përballimin e kësaj sfide për të marrë masa sot është e rëndësishme për furnizimin e sektorit në mënyrë të vazhdueshme me specialistët e duhur.

Milva Ekonomi, Ministre, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Zj. Ekonomi në fillim të fjalës së saj përshëndetëse ndau bindjen se Rrjeti Kombëtar për Zhvillimin Rural është një organizëm tjetër në jetën civile shqiptare, identiteti i të cilit është bërë i qëndrueshëm.

“Rrjeti ka bërë një punë shumë të madhe në përmirësimin e rolit të komunikimit midis organizatave të ndryshme rurale, pavarësisht se ato punojnë në zona të ndryshme. ANRD ka qenë një komunikues i mirë midis përfaqësuesve të shoqërisë civile apo të grupeve të ndryshme të interesit, të agjensive ekzekutive, siç është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, AZHBR apo të tjera institucione. Një nga mendimet goditëse në kohën e programimit të punës për strategjinë e re ishte nevoja për të bashkpunuar me Rrjetin”.

Zj. Ekonomi solli në vëmendjen e pjesëmarrësve prioritetet e punës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të tilla si rritja e konkurrenshmërisë së fermave, agropërpunimi dhe rritja e eksporteve, përmirësimi i sigurisë ushqimore etj., të cilat kanë ofruar mbështetje dhe vëmendje për zhvillimin rural. Zhvillimi i agroturizmit apo turizmit rural apo zejtarisë apo fuqizimi i grave në gjithë këto proçese, kanë qënë në vëmendjen dhe në fokus të punës së Ministrisë si mundësira dhe potenciale për përmirësimin e mirëqenies së familjeve në zonat rurale. Ministria gjithashtu theksoi performancën e suksesshme të sektorit bujqësor gjatë vitit të vështirë pandemik 2020, duke ndarë arritjet përmes shifrave: rritja e eksporteve me një vlerë të shtuar prej 9.7% krahasuar me

vitin 2019; rritja e ndjeshme e zërit prej prodhimit të bimëve bujqësore me 14.3%; peshkimit me 12.8% dhe agro-përpunimit me 4.9%. Kjo rritje, sipas Ministres, i atribuohet mbështetjes së Qeverisë dhe punës së vetë fermerëve. Ministria, gjithashtu përmendi mbështetjen financiare që ofrohet nga skemat kombëtare dhe programi IPARD, por pa harruar edhe projektin më të fundit atë të naftës falas për fermerët.

Vlen të përmendet, vëmendja e veçantë që Ministria tregoi në lidhje me fuqizimin e gruas rurale dhe fermerë, çështje që ka nxitur bashkëpunimin e Ministrisë me organizatat ndërkombëtare siç është UN Women, Bashkimi Evropian, Bashkëpunimi Italian dhe Bashkëpunimi Gjerman. Si rrjedhim, numri i grave fermere që kanë përfituar nga skemat kombëtare mbështetëse është rritur nga viti në vit. Për këtë Ministria ndau shifrat e mëposhtme: 99 milionë Lekë u përfituan nga fermeret në vitin 2019 dhe 217 milion Lekë në vitin 2020. Në këtë linjë dhe e vetëdijshme që rruga e modernizimit e bujqësisë shqiptare dhe zhvillimit të qëndrueshëm rural nuk është një rrugë e lehtë, Ministria ndau angazhimin për rritjen e fondeve në skemën kombëtare si dhe për të venë në dispozicion të fermerëve një pjesë të rrishtit të kredisë të nevojshëm për aktivitetin.

“Ajo që do të diskutoni ju gjatë këtyre ditëve lidhet me shumë aspekte të strukturës së bujqësisë shqiptare që është e dominuar nga ferma të vogla, por edhe dukuri të tjera siç është emigrimi apo kërkimi shkencor, apo qasjes në informacion, apo dhe burimet njerëzore. Adresimi i këtyre problemeve këtu sot, pa dyshim do të dojë edhe një qasje tjetër institucionale. Ministria është duke përgatitur strategjinë për periudhën 2021-2027 dhe po punohet gjithashtu edhe për përgatitjen e programit IPARD III. Ndaj jemi në një fazë ku mund të gërshetojmë rezultate që dalin nga ky Parlament rural me atë që po bënë Ministria sot. Kemi mundësinë për të marrë dhe për të bërë pjesë të strategjisë konkluzionet që vijnë nga ky Parlament. Unë besoj dhe kam bindjen e plotë se komunikimi midis nesh do të jetë një komunikim që do të ketë fryte në një dokument që do të na shërbejë dhe i aprovuar nga të gjithë ata që do të jenë zbatues të kësaj strategjie.”

Mario Mariani, Kreu i Zyrës së Bashkëpunimit, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri

Z. Mariani që në krye të fjalës së vet përshëndetëse theksoi mundësinë që Parlamenti rural shqiptar ofron për dialog dhe shkëmbim për ata që e njohin sektorin mirë, që jetojnë në sektor çdo ditë, dhe për ata që mund të kontribuojnë në sektor, politikëbërësit, OSHC-të, administrata, donatorët dhe sektori privat. Kreu i Bashkëpunimit nënvizoi rëndësinë ekonomike dhe demografike të sektorit bujqësor dhe rural, duke bërë të qartë se nuk jemi mbledhur për një pjesë dytësore të shoqërisë shqiptare.

Z. Mariani përmbloodhi objektivat për të ardhmen e sektorit shqiptar bujqësor dhe agro-ushqimorduke i përqsasur me ato evropiane – “...një sektor që krijon të ardhura dhe mundësira ekonomike, si dhe punësime që kontribuojnë në ekonominë e sektorëve të tjerë. Gjithashtu një sektor që është i qëndrueshëm dhe merr në konsideratë perspektivën afatgjatë të mjedisit dhe burimeve natyrore që ne mbrojmë, duke mbrojtur edhe bujqësinë shqiptare”.

Megjithatë, z. Mariani gjeti rastin të rendiste disa nga sfidat e sektorit duke përfshirë të drejtën e pronësisë dhe pronësinë e tokës, fragmentarizimin dhe përmasat e fermës, punën e kualifikuar, moshimin e popullatës në botën rurale. Pavarësisht kësaj, besimi në aftësinë e sektorit është arsyeja e asistencës së vazhdueshme financiare të Bashkimit Evropian prej afro 10 milion eurosh në mbështetje të bujqësisë në dekadën e fundit. Më tej, z. Mariani konfirmon mbështetjen e vazhdueshme përmes programit IPARD, zbatimi i të cilit po shkon mire dhe po përmirësohet në shumë aspekte. Vetëm në tre thirrje të programit, janë dorëzuar mbi 1000 aplikime dhe sot rreth 2500 fermerë kanë përfituar prej IPARD.

“Kjo na bën ne [BE] partnerin dhe donatorin më të madh në sektor dhe për disa arsye jemi të bindur se potenciali është aty dhe ne duam të angazhohemi në afatgjatë me ju dhe autoritetet në zhvillimin e bujqësisë dhe sektorit agro-biznesit në Shqipëri. Pavarësisht se ku mund të shkojmë, çfarëdo që donatorë të tjerë të bëjnë, ne nuk mundemi të sjellim zgjidhjet për të gjitha çështjet; ne na duhet një rol shumë i fortë dhe marrjen e përgjegjësive të plota nga autoritetet shqiptare. Është e rëndësishme që puna për strategjinë e re të bujqësisë dhe zhvillimit bujqësor si dhe përgatitja e IPARD III të bëhet në drejtimin e duhur, me burimet dhe dialogun e duhur. Kjo është provë se parlamenti rural kontribuon në drejtimet që i japin formë sektorin për vitet e ardhshme”.

Në fund të fjalës së tij, z. Mariani sugjeroi dy fusha që kërkojnë vëmendje të shtuar dhe mbështetje nga gjithë aktorët në sektor. E para lidhet me potencialin që kanë bujqësia organike, dhe mbrojtja dhe promovimi i produkteve cilësore dhe tradicionale, një potencial veçanërisht në aksesin e tregut evropian. Për ta bërë këtë siç duhet, duhet së pari korniza dhe institucionet e duhura. Fusha e dytë e cilësuar nga z. Mariani lidhet me bujqësinë që zhvillohet duke marrë parasysh ndikimin afatgjatë në mjedis, që zvogëlon degradimin e burimeve natyrore si toka, uji dhe që e bën bujqësinë më të fortë në përballjen me katastrofat natyrore. Edhe për këtë, na duhen institucione të forta dhe që kanë burime.

“Shpresoj që në dy ditët e ardhshme, aspiratat, shqetësimet dhe propozimet tuaja do të merren në konsideratë nga institucionet dhe aktorët përkatës. Dëshiroj të falënderoj ANRD, sepse kanë pasur shumë sfida për të

organizuar këtë aktivitet në këto kohë sfiduese me të cilat po përballemi të gjithë - dhe besoj se ata bënë një punë mjaft të mirë në organizimin e tij”.

Frida Krifca, Drejtore e Përgjithshme, Agjencia për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor

Zj. Krifca sjell në fjalën e vet përvojën e saj personale në lidhje me ekspozimin ndaj jetës së fshatit dhe njerëzve në komunitetet rurale. Pozicioni i saj i punës, shumë i rëndësishëm në zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural e ka lidhur në mënyrë të përditshme me jetën, ekonominë dhe dinamikat e fshatit shqiptar. Ajo tregon se ka takuar njerëz të punës, të gjithë me përkushtim dhe sakrificë që kujdesen për fermat e vogla e të mëdha, për mirëqenien e tyre, miqve të tyre dhe familjeve të tyre dhe ka arritur në përfundimin se fshati ka një potencial të jashtëzakonshëm për të krijuar zhvillim dhe mirëqenie për ekonomitë e vogla dhe zhvillimin e ekonomisë së vendit. Me këtë njohje të potencialit dhe dëshirës për punë, Zj. Krifca, ka drejtuar Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Bujqësor duke zbatuar politikat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të cilat kanë synuar shëndrrimin e bujqësisë nga një sektor mbijetese në një bujqësi moderne. Ajo thekson kontributin e AZHBR-së, i cili nuk lidhet thjesht vetëm me investimet moderne në sektor, por për të treguar që fshati dhe hapësira rurale e vendit është një faktor zhvillimi i qënësishëm për ekonominë dhe demografinë e vendit.

“Çfarë kemi bërë ne për të zbuluar thesarin e fshatit shqiptar. Duke pasur si synim kryesor transformimin e bujqësisë, nga puna e bërë me ngastra në mekanizimin e saj në një ekonomi shkalle që kursen kohë, ul kostot por rrit dhe cilësinë e produkteve, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë investimeve të reja teknologjike, duke përafuar produktet shqiptare me standartet e Bashkimit Evropian. Investime që i shtohen gamës së sipërmarrjeve bujqësore blegtorale, risi teknologjike duke tentuar të krijojnë në fakt një panoramë të një ferme mikse moderne me cilësi dhe standarte evropiane, e cila në fakt jo vetëm rrit të ardhurat e saj por kontribuon edhe në ekonominë e vendit, kontribuon në mbrojtjen e mjedisit. Sot në fshat shkohet jo vetëm për agro-turizëm, por shkojnë kompani për të diversifikuar protofolet e tyre të biznesit, shkojnë start up që nëpërmjet punës së tyre në fshat mund të gjenerojnë të ardhura”.

Ndër të tjera, Drejtoresha pranon se rruga drej zhvillimit të qënësishëm dhe e modernizimit të bujqësisë është e gjatë. Megjithatë, ajo pohon se AZHBR ka vendosur disa gurë kilometrikë, në mënyrë që ky zhvillim të jetë i qëndrueshëm. Më tej, Zj Krifca ndan statistika të tre viteve të fundit në ofrimin e mbështetjes financiare në sektor:

- Janë mbështetur rreth 345 investime në asete fizike të patjetërsueshme në 45 bashki të vendit; 143 prej tyre janë start-upe, biznese të reja;
- mbi 3100 vënde të reja pune të krijuar në fshat nga investimet e mësipërme;
- është ulur mosha mesatare e personave që merren me bujqësi; raportohet 41% të rinj më shumë të angazhuar në sektorin bujqësor si aplikantë;
- është rritur përfshirja e grave në sektorin e bujqësisë si sipërmarrëse dhe drejtuese e procesit të zhvillimit të bujqësisë; raportohet më shumë se 40% gra të angazhuar në në sektorin bujqësor si aplikantë;
- destinacionet turistike, kulinare dhe akomoduese janë shtuar në 60 prej tyre.

Duke pranuar se grupi i aplikantëve nuk është përfaqësues i të gjithë sektorit, por tregon mjaftueshëm edhe formalitetin dhe ardhmërinë dhe jetëgjatësinë e atyre që merren me bujqësi, që e shohin bujqësinë jo si mbijetesë por si e ardhur kryesore, drejtoresha siguron se këto janë të dhëna të konsiderueshme. Këto të dhëna dëshmojnë rëndësinë e investimit në bujqësi dhe përfitimeve që merren nga ky sektor. Duke pranuar më shumë gra dhe të rinj në këtë sektor japim një kontribut të rëndësishëm për ekonominë e fshatit dhe mirëqënies rurale.

Zj. Krifca flet për qasjen e punës së AZHBR-së, që në qendër ka fermerin dhe lehtësitë që duhen krijuar në qasjen në informacion, në financa, në asistencë etj për të bërë më të lehtë jetesën. AZHBR ka bërë ndryshime rrënjësore për të lehtësuar procedurat, dokumentacionin në aplikimin e masave direkte, duke formalizuar proceset dhe mundësuar aplikimin online në mënyrë që të shmanget konfuzioni, rradhët dhe reduktuar kostot administrative. Kjo qasje pune është kthyer me rritjen e besimit të fermerëve, që tregohet me një numër të rritur të aplikimeve për skemat mbështetëse dhe programin IPARD. Vetëm në skemën kombëtare është rritur me 20% numri i aplikimeve nga viti 2019 në 2020.

“Në 2018 morëm besimin e BE-së për të zbatuar programin IPARD dhe falë këtij programi vumë në dispozicionin të fermerëve dhe agro-përpunuesve fondin 94 milion euro. Tripartiteti ndërmjet BE-së, Qeverisë Shqiptare dhe fermerëve dhe agropërpunuesve shqiptarë ka bërë që ky fond të arrijë në 124 milion euro. Kemi administruar tre thirrje në kuadër të programit, janë mbështetur 288 kontrata për investime që fillojnë nga 10 mijë euro në 2 milion euro. Këto investime janë gjeneratorë të rëndësishëm të zhvillimit rural dhe bujqësor në vend”.

Petar Gjorgievski, President, Rrejtji Ballkanik për Zhvillimin Rural (Balkan Rural Development Netëork)

Z. Gjorgievski fillimisht shprehu kënaqësinë për të adresuar pjesëmarrësit e një eventi të tillë në emër të gjithë rrjeteve rurale të Ballkanit duke përfshirë Bosnjë-Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi, Republikën e Maqedonisë Veriore, Serbinë. Ai përgëzoi ANRD në organizimin e Parlamentit në mesin e vështirësive të shkaktuar nga pandemia globale Covid-19. Presidenti i BRDN ndër të tjera ndau:

“Ne kemi mundësinë që të ndajmë sa më shumë të jetë e mundur përvojat tona nga ky event për të kontribuar dhe pse jo për të replikuar ato çështje dhe aspekte që janë të ngjashme. Dihet që vendet e rajonit përballojnë sfida dhe probleme të ngjashme. Trendi i organizimeve të parlamenteve rurale në vendet e Ballkanit Perëndimor po rritet dhe tashmë parlamentet rurale zhvillohen në disa prej tyre. Aktualisht kemi në Kosovë, Maqedoninë Veriore, Bosnje-Hercegovinë, dhe tani ato po zhvillohen në një nivel më të lartë, në nivel rajonal dhe evropian. Aktualisht zhvillohet Parlamenti evropian, këtë vit parlamenti i pestë, dhe Parlamenti ballkanik që do të zhvillohet këtë qershor, në qytetin e Ohrit në Maqedoninë Veriore. Parlamentet janë forume pjesëmarrëse të aktorëve vendorë dhe në nivelin qendror, ku ata kanë mundësi të diskutojnë dhe debatojnë çështje që janë të rëndësishme për komunitetet e tyre rurale. Parlamentet janë nisma advokuese të organizuara nga shoqëria civile në partneritet me qeverisjen. Ne besojmë se është një mundësi për të rritur zërin e komuniteteve për prioritetet dhe çështjet e tyre të rëndësishme”.

SESION PLENAR: Debati aktual mbi Shqipërinë rurale. Mundësitë dhe sfidat

Dy raste nga realitetet rurale aktuale që shërbyen si shkëndija për debatin plenar u prezantuan nga dy pjesëmarrës virtual në Parlamentin rural, të cilët përfaqësojnë aktorë të ndryshëm të zhvillimit rural në vend. Secili prej tyre prezantoi një 'rast specifik', një realitet rural që përjetohet nga një komunitet i caktuar, por në të njëjtën kohë ato rezatojnë një problematikë a shqetësim edhe për komunitetet më të gjera në Shqipëri.

Rasti 1: Frashëri çka qenë, ç'është dhe çdo të bëhet: Frashëri një histori e lavdishme, e tashme e shënuar nga braktisja dhe shpopullimi dhe e ardhme në kërkim të shpresës e ringritjes.

Prezantuar nga **Tomor Kotorri, Kryetar i shoqatës kulturore mbarëkombëtare 'Vëllezërit Frashëri'**

Periudha e lulëzimit

Me një bukuri natyrore mahnitëse, pranë Bredhit të Hotovës, Frashëri është një kupë qielli mes malesh që i dha aq shumë dritë dhe dituri Shqipërisë dhe shqiptarëve.

I dokumentuar rreth viteve 1650-1655 si ngulim, me një histori mbi 600 vjeçare, Frashëri ka shkëlqimin dhe lavdinë e vet. Është zona, që ndër të parat, ka zgjuar frymën kombëtare e që ka ndikuar fuqishëm për të ngjizur kombin shqiptar. Por ajo ç'ka e bën Frashërin monument të historisë dhe të kulturës tonë kombëtare është se i ka dhënë kombit tre kolosë të historisë, mendimit dhe kulturës: burrin e shtetit dhe diplomatin Abdyl Frashëri, poetin kombëtar Naim Frashëri, ideologun dhe shkencëtarin Sami Frashëri, pa veprën e të cilëve nuk mund të kuptohet rilindja e kombit tonë.

Frashëri ka njohur një zhvillim e lulëzim ekonomik deri në vitin 1914. Për Sami Frashërin dhe Pukëvilin, në gjysmën e dytë të shekullit XIX, Frashëri nuk ishte thjesht një fshat, por "një qytet i vogël malor zotërinjsh" me infrastrukturën arsimore në 6 gjuhë të huaja, të shërbimeve, tregtisë etj që i takojnë një qyteti të vërtetë. Fshati njohu lulëzimin e tij të dytë para viteve '90, me gjithë kufizimet e sistemit si në të gjithë vendin. Popullsia arriti mbi 772 banorë, në çdo fshat kishte shkollë 8-vjeçare, qendër shëndetësore, në Frashër kishte shkollë të mesme me konvikt, spital zonal, 5-6 dyqane, linjë të rregullt urbane dhe telefoni etj.

E sotmja e shënuar nga rrënimi dhe braktisja: Të gjithë ne i njohim dhe i kemi pjesë të ndërgjegjes sonë kombëtare Frashërin dhe Frashërlinjtë. Por, ah sikur ta shihnit me sytë tuaj si është braktisur dhe shkretuar kjo zonë! Shkretimi ka ardhur jo vetëm për shkak të lëvizjes së lirë për një jetë më të mirë, por sidomos nga mungesa të rëndësishme e jetike. Dëmtimi dhe mungesa e riparueshme e infrastrukturës rrugore, rrënimi i ekonomisë, largimin i intelektualëve, mungesat në shërbimin shëndetësor dhe arsimor, sollën largimin me shumë se 75% e popullsisë. Sot fshati Frashër banohet nga 22 familje me 72 banorë në stinën e verës ndërsa, në dimër dhe stinët e tjera nga vetëm 7 familje dhe 28 banorë të përhershëm.

Me vështrimin nga e ardhmja: Edhe pse i braktisur Frashërin nuk e mban dot sot as Bashkia Përmet, Prefektura, apo Qarku i Gjirokastrës. Ai është i Kombit dhe kështu duhet ta vlerësojmë. Ai është unikal, e kërkon që shteti e shoqëria shqiptare ta shohë unikal, si një zë më vete në zhvillimin e përparimin e vendit. Për këtë kanë kontribuar edhe veprimtaritë e organizuara nga ish komuna, bashkia Përmet dhe shoqata atdhetare kulturore mbarë kombëtare vëllezërit Frashëri.

Organizimi i këtyre veprimtarive është njëherësh edhe një thirrje për të ruajtur e lartësuar emrin e Frashërit dhe për sensibilizimin e shqiptarëve, të shtetit dhe miqve e donatorëve që, me projekte të veçanta, të mbështesin e ndihmojnë fuqishëm Frashërin me qëllim që ai të kthehet në një qendër historike – turistike – muzeale. (pavarësisht perpjekjeve nuk kemi arritur ndonje rezultat konkret).

Cilat janë resurset ku mund të mbështetet ringritja e Frashërit: Historia e Frashërit është një monument i madh, kulture dhe turizmi i Shqipërisë. Atë të tillë e bënë vëllezërit Frashëri, natyra, shtëpia muzeale e vëllezërve Frashëri, Teqea e atdhetarëve Baba Nasibiut, Baba Alushit. Frashëri dhe zona për rreth janë të pasura me florë dhe faunë, kanë klimë e resurse ekologjike të rralla, kanë Parkun Kombëtar të Bredhit të Hotovës, burime ujërash të kristalta, mundësi reale për zhvillimin e turizmit malor. Ozoni i Bredhit të Hotovës është rast i veçantë në vendin tonë, siç pohojnë edhe specialistët evropianë që e kanë parë nga afër këtë park.

Komuniteti i Frashërit, jashtë dhe brenda fshatit, në bashkëpunim me specialistë të fushave të ndryshme, kanë hartuar dhe paraqitur në institucionet shtetërore përkatëse projekte për rimëkëmbjen e Frashërit.

Problemi më i rëndësishëm është ndërtimi i rrugës automobilistike Përmet-Frashër, e cila sot është në gjendje të vajtueshme. Është një rrugë, e cila zgjatet jo më tepër se 30.5 km, për të cilën është bërë edhe projekti i ndërtimit të rrugëve sekondare që lidhin Frashërin me fshatrat përreth.

Ndërtimi i një spitali ose e qendër kurative për ripërtitjen e shëndetit të njerëzve me sëmundje të mushkërive.

Rikonstrukcioni dhe rijetëzimi i shtëpisë muze të vëllezërve Frashëri, si dhe rikonstrukcioni i shkollës së parë shqipe për rrethin e Përmetit, në Frashër.

Frashëri të orientohet drejt turizmit familjar nëpërmjet zbatimit të studimit për ruajtjen e urbanistikës së qytezës së vjetër të Frashërit. Ky projekt parashikon ngritjen e shtëpive dhe vilave turistike për vizitorë.

Ndërtimi i aksit nacional të rrugës Sarandë - Gjirokastrë – Përmet – Korçë, i cili të kalojë edhe nga Frashëri, duke shkurtuar distancat.

Realizimi i këtyre masave do ta kthejë Frashërin në një qendër mbarëkombëtare shëndetësore, për zhvillimin e turizmit historik-kulturor dhe ekologjik, duke kontribuar edhe në zhvillimin ekonomik të trevës së Dangëllisë dhe të qytetit të Përmetit. Në shumë vende të botës i sajojnë simbolet dhe investojnë për to ndërsa Frashëri duke qenë simbol i gjallë i kombit bën thirrje në çdo kohë për t'u mbrojtur dhe zhvilluar se brenda tij qëndron historia e shkrirë me natyrën e bukurinë shqiptare. Faleminderit!

Rasti 2: Gruaja rurale pukjane midis sfidave dhe përpjekjeve për fuqizim

Prezantuar nga **Marie Frroku, Lidere e Grupit të Grave, Gjegjan, Pukë**

Rrëfimi i një gruaje në luftë me kufizimet që rrjedhin nga mentaliteti konservator, kushtet e vështira të mjedisit, kontributi i mohuar në familje e shoqëri e që kërkon para së gjithash të sjellë historinë, sfidat dhe arritjet e grave pukjane që ndajnë të njejtat probleme e përpjekje për zhvillim e fuqizim.

Zj. Frroku bën një panoramë të problematikës në zonën ku jeton, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të zhvillimit social dhe ekonomik në territorin të cilin dëshiron që të mos e braktisë. Thirrja e saj është një apel për shoqërinë dhe shtetin për kontribute më gjithpërfshirëse për zonat e dizavantazuara rurale dhe në veçanti për gratë të cilat kërkojnë më shumë mbështetje për të realizuar rolin e tyre në shoqëri, komunitet dhe familje.

“Jam Marie Frroku nga njësia administrative Gjegjan e bashkisë Pukë, me profesion ekonomiste, nënë e pesë fëmijëve. Prej 17 viteve jam angazhuar në drejtimin e një grupi prej 22 grave në fshatin tonë i ngritur nga shoqata Agropuka me ndihmën e WE Effect. Ndër vite, sfidat kanë qenë të ndryshme duke nisur nga mentaliteti i zonës mbi rolin e gruas në shoqëri e deri tek probleme të tjera të cilat kanë prekur familjet e zonës. Përgjithësisht jemi angazhuar në përpunimin e frutave dhe perimeve, duke siguruar produkte jo vetëm për konsum familjar por gjithashtu edhe për përfitime ekonomike, duke kontribuar në ekonominë familjare. Krahas kësaj, grupi ynë është angazhuar edhe me problemet sociale që janë të shumta të tilla

si: martesat në moshë të hershme, divorcet etj. Gratë në zonat rurale janë të persektuara në mënyrën e jetesës që bëjnë, duke nisur nga puna e lodhshme dhe e papaguar, që nuk njihet si punë, por si detyrim”.

Maria në fjalën e saj përmbledhi problemet me të dukshme që përjetojnë komunitetet rurale dhe veçanërisht gratë: largimi i të rinjve dhe fuqisë punëtore të aftë për punë; mungesa e promovimit të zonave tona, e investimeve publike në zonë, varfëria dhe pamundësia për hapjen e bizneseve të vogla, mungesa e lehtësive për bizneset, mungesa e theksuar e mbështetjes për start-ups me fokus zonat e largëta. Zbehja e shpresës për të vazhduar jetën në Shqipëri jo vetëm tek të rinjtë po tek i gjithë komuniteti është problemi final që të gjitha problemet e përmendura sjellin.

Në fund të fjalës së vet, Maria u fokusua në problemet kryesore të grave, ku ndër të tjera evidentoi:

Organizimi i punës në fshat: Gratë janë të përjashtuara nga vendimarrja. Jeta në fshat organizohet sipas strukturave të përcaktuara në ligj, sikurse janë këshilli i fshatit, kryepleqësia dhe kryeplaku. Ende nuk njohim ndonjë fshat në Shqipëri që të ketë zgjedhur për kryeplak një grua.

Ekonomia në fshat: Pamundësia e grave për të marrë pjesë në skemat kombëtare, pasi pronat dhe tokat janë të palegalizuara. Mungesa e dokumenteve të pronësisë përjashton komunitete rurale si dhe gratë fermere nga investimet në fermë.

Jeta sociale e grave rurale: gratë nuk kanë jetë sociale, nuk ka aktivitetet që gratë të mblidhen e të bisedojnë, me përjashtim të fushatave zgjedhore etj. Qendrat sociale ose mungojnë ose në rastin kur janë ndërtuar rrinë me derë mbyllur.

Shërbimet publike: edukimi, shëndetësia, bankat dhe bankomatet ende janë shërbime që gratë i aksesojnë duke udhëtuar me kilometra.

Në emër të gjithë grave dhe vazjave në zonat rurale, Maria i bënë thirrje aktorëve të ndryshëm, qeveritarë dhe jo-qeveristare të zbresin në fshat e të dëgjojnë zërin e grave.

Rasti 3: Ide nga fermerët shkodranë mbi mundësinë e përmirësimit të mbështetjes nga skemat kombëtare të bujqësisë e blegtorisë

Prezantuar nga **Isak Bajrami, Kryetar i Federatës Bujqësore Shkodër**

Rëndësia e përfshirjes së inputit dhe ideve të të gjitha palëve të interesit në konceptimin e skemave mbështetëse të bujqësisë dhe blegtorisë prezantohet nga një fermer dhe përfaqësues i interesave të fermerëve e prodhuesve të Qarkut Shkodër. Ai sjell një panoramë të gjallë të kontrastit midis potencialit të madh për zhvillim bujqësor dhe rural që mbart zona e Shkodrës dhe kushteve të vështira sociale dhe ekonomike të zonave më të largëta malore e atyre rurale.

Duke vlerësuar çka ka shkuar mirë në hartimin dhe zbatimin e skemave mbështetëse, sidomos në lidhje me harmonizimin e financimit nga programi IPARD me atë nga Skemat Kombëtare, ai ofron dhe kërkon bashkëpunim më të ngushtë me strukturat përgjegjëse shtetërore në lidhje me këtë çështje. Institucionalizimi i këtij bashkëpunimi shihet nga fermerët shkodranë si faktori kryesor për rritjen e efektivitetit të këtyre skemave në nxitjen e zhvillimit bujqësor e rural në zonën e Shkodrës.

Rasti 4: Shembulli pozitiv i kontributit të kooperativave bujqësore për sigurinë ushqimore dhe koordinimin brenda zinxhirit të vlerës

Prezantuar nga **Piro Jongari, drejtues kooperative bujqësore, Lushnje**

Në Shqipëri boshllëqet e zhvillimit në fushën e sigurisë ushqimore po kërkojnë një koordinim vertikal më të fortë brenda zinxhirëve të vlerës së ushqimit. Aktualisht ekzistojnë përvoja pozitive që forcojnë koordinimin vertikal përmes zhvillimit të kooperativave bujqësore dhe grupeve informale të fermerëve.

Prezantimi pasqyron dy raste pozitive të raportuara, kur kooperativat kanë rezultuar si mjaft të dobishme për plotësimin e nevojave të përmirësimit të koordinimin vertikal. Gjithshtu paraqiten raste që zbulojnë se agjentët e agrobiznesit, promovojnë, mbështetin dhe madje bëhen iniciatorë të kooperativave dhe grupeve informale të fermerëve, me qëllim që të zbatohen standartet e sigurisë ushqimore. Bashkëpunimi në zhvillim midis fermerëve jo vetëm që rrit pjesëmarrjen e tyre në zinxhirin e vlerës, por gjithashtu gjeneron besim të ndërsjellë.

Ilnisa Agolli, gazetare e emisionit “Fshatrat e Shqipërisë”, Televizioni Top Channel

Duke u nisur nga përvoja e saj e pasur në eksplorimin e fshatrave të Shqipërisë nga veriu në jug, zj. Agolli u përqendrua në evidentimin e kontrastit midis realiteteve rurale dhe idealizimit të situatës së këtyre zonave për shkak të mosnjohjes. Pasi iu referua rasteve studimore, me fokus të veçantë rastin e eksodit rural nga fshati Frashër i Përmetit, ajo nënvizoi emergjencën që ka shkaktuar ky eksod në zhvillimin socio-ekonomik të zonës. Duke theksuar rëndësinë e zonave rurale për zhvillimin e vendit, ajo vuri në dukje hendekun që ekziston midis potencialit endogjen të këtyre zonave dhe zhvillimit aktual social-ekonomik shpesh të ndaluar për shkak të mungesës së interesit dhe vëmendjes nga shteti, e konkretizuar kjo nga investimet dhe infrastruktura e munguar.

Pasi vijoi më tej me rrëfimin e rrugëtimit në zonat rurale, gazetarja evidentoi nevojën e pasqyrimit real dhe sa më me besnikëri të këtij realiteti dhe transmetimit të zërit dhe prioritetëve të komuniteteve vendore në instancat politikëbërëse e vendimmarrëse si edhe tek opinion publik në përgjithësi. Zj. Agolli vuri në dukje rolin e dorës së parë që media me ndjeshmërinë dhe objektivizmin e saj luan në rritjen e vëmendjes së shtetit dhe aktorëve të zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor dhe rural ndaj zonave të shpopulluara për rikthimin e shpresës dhe dëshirës së komuniteteve rurale për të jetuar aty. Ilnia përfundoi rrëfimin e saj:

“Në fshatrat e Shqipërisë ka pasuri të mëdha natyrore dhe kulturore. Le të bëjmë përpjekje për t’i evidentuar ato dhe për të përmirësuar dalëngadalë jetën e fermerëve dhe të gjithë shqiptarëve në përgjithësi. Duhet të kemi rezultate konkrete që t’i prezantojmë më kënaqësi si suksese kur të mbledhemi në tryezën e Parlamentit të ardhshëm rural”.

Lauresha Grezda, Drejtore e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Duke theksuar bashkëpunimin e mirë midis MBZHBR-së, ANRD-së dhe UBT-së zj. Grezda vlerësoi rolin e Parlamentit Rural për vendosjen e një lidhje dhe komunikimi më të drejtpërdrejtë me komunitetet rurale dhe aktorët e tjerë të zhvillimit rural. Zj. Grezda e cilësoi Parlamentin një instrument të rëndësishëm për të adresuar problematikat e zhvillimit rural në Shqipëri, veçanërisht në kuadër të procesit të hartimit të Strategjisë së re të Zhvillimit Bujqësor dhe Rural.

Duke iu referuar rasteve të prezantuara, ajo nënvizoi rëndësinë që i është dhënë në Strategji fuqizimit të grave rurale si nëpërmjet bonusit gjinor

në skemat mbështetëse ashtu edhe fondeve të dedikuara për ngritjen e kapaciteteve të tyre. Në përgjigje të shqetësimit të ngritur rreth çështjeve të titujve të pronësisë dhe përdorimit të pronës si kolateral kreditimi në lidhje me skemat mbështetëse, zj Grezda përmendi fondet e garancisë të zbatuara nga KfW dhe BERZH të cilat ndihmojnë zgjidhjen e problemit. Ndërsa në lidhje me ligjin mbi SHBB-të, Drejtoresha e politikave nënvizoi nevojën për advokaci për të adresuar dinamikat e reja dhe prioritetet e komuniteteve rurale, duke inkurajuar më tej bashkëpunimin e vendosur me shoqërinë civile e veçanërisht me ANRD dhe akademinë në këtë fushë.

Në vijim zj. Grezda theksoi rëndësinë e trajtimit në mënyrë të integruar të problemeve të zhvillimit bujqësor dhe rural në vend. Në kuadër të hartimit të Strategjisë së re, ajo përmendi rëndësinë e procesit të identifikimit të grupeve prodhuese aktive në vend, veçanërisht grupeve të grave, dhe orientimin e tyre drejt produkteve tradicionale e organike si dhe proceseve të çertifikimit, të treguesve gjeografikë dhe gjetjes së tregjeve për prodhimet e tyre. Gjithashtu, ajo theksoi edhe rolin e rëndësishëm të medias së shkruar dhe vizive për promovimin e produkteve vendase dhe zinxhirit të vlerës, duke e ftuar median të bashkëpunojë më tepër me MZHBR për të mundësuar më shumë informacion dhe njohuri për publikun e gjerë mbi veprimtarinë e saj.

Në lidhje me Parlamentin Rural, zj Grezda u shpreh: “Për Ministrinë, Parlamenti Rural është një nga eventet kryesore ombrellë për vetë faktin që ne marrim input e informacion për ta transmetuar e integruar në mënyrën më të mirë të mundshme me grupet e interesit. Gjithashtu, bashkëpunimi i vazhdueshëm me ANRD dhe UBT ka ndikuar në iniciativat që ka ndërmarrë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.

Erinda Lika, zv/Rektore e Shkencës dhe Projekteve, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Në fjalën e saj zj. Lika vlerësoi përfshirjen e akademisë në nismat advokuese mbi politikat dhe instrumentet e zhvillimit bujqësor dhe rural. Në përgjigjeve të rasteve studimore zv/rektorja u përqendrua tek eksodi rural si një rast jo i izoluar dhe që kërkon zgjidhje. Në këtë kontekst ajo prezantoi përvoja dhe metoda shkencore për trajtimin e shkaqeve dhe pasojave të eksodit rural duke theksuar si një rrugë suksesi zbatimin dhe promovimin e modeleve territoriale të zhvillimit dhe qasjen LEADER nëpërmjet programit IPARD. Në aspektin akademik, zj Lika u përqendrua tek ngritja e stacioneve të parashikimit dhe informimit për sëmundjet në bimë dhe pemtari, mbrojtjes nga breshëri, mbrojtjes së mjedisit dhe peizazhit etj., të cilat i konsideroi si parakushte të rëndësishme për zhvillimin e

turizmit rural dhe agroturizmit, fuqizimin ekonomik të zonave rurale dhe parandalimin e valëve të emigracionit. Duke u ndalur në problemet që lidhen me integrimin e gruas rurale, ajo theksoi nevojën e koordinimit dhe shtrirjes kapilare të veprimtarisë dhe pranisë së shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë në të gjitha zonat rurale të vendit si edhe përfshirjen e sa më shumë grave rurale në këto veprimtari.

Zj Lika gjithashtu evidentoi rolin e universiteteve në përgatitjen e ekspertëve dhe këshilltarëve lokalë për zhvillimin bujqësor dhe rural në ndihmë të fermerëve, insitucioneve politikëbërëse, institucioneve ligjzbatuese etj., në përgjigje të sfidave aktuale të konkureshmërisë, rritjes së produktivitetit, mbrojtjes së biodiversitetit etj. Ky rol mund të identifikohet në fushën e konsulencës dhe aktiviteteve për grupet dhe shoqatat e prodhuesve si edhe përzgjedhjen dhe planifikimin e projekteve me qasje pjesëmarrëse që marrin në konsideratë nevojat dhe prioritetet e komuniteteve lokale.

Ndër të tjera zj Lika shtoi se “Si përfaqësues të Universitetit jemi të nderuar për përfshirjen në çështje sensitive të zhvillimit bujqësor dhe rural të tilla si siguria ushqimore, integrimi social e ekonomik i gruas dhe të rinjve ruralë, apo dhe eksodi rural. Nga këndvështrimi akademik, çështja e eksodit rural është një çështje që na prek të gjithëve. Duke u nisur nga njohuritë dhe evidencat e deritanishme do të propozonim modele zhvillimi që janë në harmoni me kushtet klimaterike, me eksperiencën, traditën dhe historinë e këtyre zonave”.

Birgit Schaefer, Konsulente, Bashkëpunimi Ndërkombëtar për Zhvillim, GIZ

Si eksperte me përvojë të gjatë në zhvillimin rural dhe bujqësor, zj. Schaefer aktualisht është Drejtuese e Skuadrës së projektit të GIZ që zbatohet nga një kompani gjermani në kuadër të projektit SRD (Zhvillimi i Qëndrueshëm Rural). Në vijim të çfarë u tha edhe më herët nga Ministria dhe përfaqësues të lartë të Ministrisë, zj. Schaefer informoi se Ministria po përgatit Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit për 7 vitet e ardhme. Kjo strategji do të përgatitet me ndihmën e ekipit të ekspertëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, dhe do të ndjekë udhëzimet e BE-së. Për këtë arsye, zj Schaefer vlerëson pjesëmarrjen në këtë event si një mënyrë për të dëgjuar reflektimet e pjesëmarrësve. Ajo gjithashtu ndau informacion mbi natyrën pjesëmarrëse të procesit planifikues, çka është shumë e rëndësishme për të mbledhur opinionet e popullatës rurale, fermerëve dhe sipërmarrësve rural etj. Procesi strategjik drejtohet nga grupi drejtues në Ministri dhe drejtohet nga Ministria.

“ANRD si një organizatë ombrellë që përfaqëson 27 organizata të shoqërisë civile do të përfshihet në këtë proces për të diskutuar më nga afër sfidat dhe se në ç’mënyrë mund t’i adresojmë ato në mbështetje të masave që do të jenë të disponueshme përgjatë viteve në të ardhmen.”

Procesi planifikues i strategjisë do të ofrojë mundësi për kontribute nga aktorët, përfshi edhe ANRD si në procesin e verifikimit ashtu edhe të konsultimit me aktorët e interesit. Në këtë kontekst zj Schaefer shprehet entuziaste për të shkëmbyer më shumë mbi gjithë sfidat e përmendura në vlerësimin e situatës si për shembull: vështirësia për investime të tilla si mungesa në aksesin e të drejtës së pronësisë, aksesi në kredi, por edhe si mund të përmirësohet roli dhe pjesëmarrja e të rinjve për të pasur zhvillim rural të qëndrueshëm në vitet e ardhme. Drejtuesja e ekipit ofron informacion edhe mbi tema të tjera që Strategjia do të trajtojë sikurse janë çështjet që ofrohen nga korniza evropiane të tilla si: trajnimi për ekonominë rurale, përshtatja me ndryshimet klimatike, si mund të mbështeten fshatrat e zgjuar dhe në çmënyrë zonat rurale të lidhen.

Zigo Rutkovskis, Njësia e Ndhmës së Para-pranimit, Drejtoria e Përgjithshme e Bujqësisë, Komisioni Evropian

z. Rutkovskis filloi reagimin e vet duke sjellë në vëmendje të pjesëmarrësve zbatimin e suksesshëm të programit IPARD II dhe ofroi një panoramë të plotë edhe për programin IPARD III. Sipas përfaqësuesit të DG Agri-t, IPARD II provoi popullaritetin e vet në mesin e fermerëve dhe popullatës dhe pati një numër të konsiderueshëm të aplikimeve që propozuan më shumë se 100 milion euro. Pavarësisht se realizimi i gjithë propozimeve është i pamundur, megjithatë kjo tregoi rëndësinë e instrumentit financiar dhe mundësitë që ofron për vendin. Periudha tjetër do të ofrojë edhe më shumë mundësi për vendin në terma të masave dhe ato financiar. Shqipëria në kuadër të programit IPARD aktualisht zbaton vetëm katër masa, shumica e tyre të lidhura me infrastrukturën në fermë, përmirësimin e infrastrukturës dhe njësi përpunuese, gjithashtu diversifikimin në zonat rurale dhe asistencë teknike. Ndërsa me programin e ri do të ketë mundësi për zgjedhje në mesin e 13 masave. z. Rutkovskis siguroi që Autoriteti Menaxhues në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka vendosur objektiva ambicioz për të zbatuar 11 masa në gjithë programin, çka do të ofrojë mundësi shtesë për aktorët e interesit. Këtu, z. Rutkovskis përmendi rrjetet rurale, grupet lokale të veprimit si dhe projektet që theksojnë rëndësinë e grave të cilat do të jenë prioritare. Rrjeteve Kombëtare Rurale do t’u ofrohet mundësia nëpërmjet masës së asistencës teknike që të forcohen. Shqipëria ka zgjedhur të zbatojë masën e qasjes Leader e cila është shumë e rëndësishme për të promovuar grupet lokale të veprimit,

veprimet lokale dhe fuqizimin e rolit të gruas duke filluar nga 2021. Ai vazhdoi më tej duke prezantuar mundësi në të ardhmen për zbatimin e masave që promovojnë bashkëpunimin, shërbimet këshillimore të cilat do të ofrojnë mbështetje për projekte kolektive që nxisin inovacionin dhe përfshijnë bashkëpunimin mes fermerëve, sipërmarrësve dhe studiuesve.

Me vlerë ishin konsideratat që ndau në lidhje me Programin e mbështetjes kombëtare dhe rëndësinë e rritjes së kësaj mbështetje, duke ritheksuar se opinioni i Komisionit Evropian e konsideron mbështetjen kombëtare si komplementare të mbështetjes së ofuruar nga BE.

“Qasja se aksesit në programet e BE-së zëvendëson mbështetjen kombëtare nuk është qasje korrekte. Në parim, programet kombëtare duhet të ofrojnë mbështetje shtesë për fermerët, prodhuesit, grupet lokale të veprimit përveç masave të përfshira në programin IPARD. Ajo çka mund të merret në konsideratë është dallimi, për shembull në skemat kombëtare mbështetje mund të ofrohet për fermat e vogla familjare, ndrsa në IPARD mund të mbështeten projekte më të mëdha që kërkojnë përgatitje dhe më shumë financim. Në këtë fazë programimi është e rëndësishme të shihen mundësi të tjera financimi, sespe ka shumë organizata donatore në Shqipëri që mund të ndihmojnë duke bërë kujdes mbivendosjen e fondeve”.

Në reagim rreth rastit mbi braktisjen e zonave rurale, z. Rutkovskis përmendi se IPARD III përmban masë për infrastrukturën publike rurale dhe Autoriteti Menaxhues ka vendosur të zbatojë këtë masë nën këtë program në periudhën tjetër programuese. Në këtë masë përfshihet infrasturura rrugore ndër të tjera. Kur bëhet fjalë për infrastrukturë më të madhe do të jetë e nevojshme mbështetje e IPA-s.

“Shpresoj shumë të përfitoni nga masat e përmendura, sikurse është qasja Leader, që është shumë e rëndësishme për grupet lokale të veprimit, të cilat po forcohen çdo vit në Shqipëri. Ndaj do të jetë koha e duhur për të ofruar mbështetje shtesë për zhvillimin e tyre. Kjo masë do të përfshijë mbështetje për projekte të vogla deri në 5000 euro, që synojnë rigjenerimin e zonave rurale si dhe përfshirjen sociale. Gjithashtu, përmenda mbështetjen për rrjetet kombëtare rurale në kuadër të masës së Asistencës Teknike. Kjo është një mundësi e re për të zhvilluar rrjetëzimin, çka është veçanërisht e rëndësishme për këtë event dhe për pjesëmarrësit këtu sot, sepse ofron mundësi të tjera për zhvillimin rural në vend dhe për rrjetëzimin më të gjerë në rajon”.

z. Rutkovskis përfundoi fjalën e vet duke vënë theksin në disa pika të dobëta të legjislacionit kombëtar të cilat ndikojnë në zbatimin e porgramit IPARD në Shqipëri. Ai tërhoqi vëmendjen e përfaqësuesve të Ministrisë në lidhje me kornizën ligjore mbi Rrjetin Kombëtar për Zhvillimin Rural,

Grupet lokale të Veprimit, regjistrin e fermave dhe të tjera çështje që duhet të zgjidhen për t'i paraprirë hapjes së negociatave të Shqipërisë me BE. Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me kërkesat e BE është i rëndësishëm për përshpejtuar integrimin e Shqipërisë dhe për të ndihmuar zbatimin e programeve të BE-së. Kjo do ta bënte këtë proces një histori suksesi sikurse ishte edhe zbatimi i programit IPARD II.

Sotirag Hroni, Kryetar Bordi, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural

Reagimi i z. Hroni në lidhje për sa më sipër u përqëndrua në rolin dhe kontributin që japin aktorët e sektorit civil në adresimin e sfidave të zhvillimit të qëndrueshëm rural dhe mirëqeverisjes së sektorit bujqësor dhe rural. Së çfarë konkretisht mund të bëjë shoqëria civile, z. Hroni solli në vëmendje të pjesëmarrësve përvojën e ANRD në pesë vitet e fundit si një përvojë pozitive të sektorit civil në këtë drejtim. Kryetari i bordit tregoi zgjerimin e anëtarësisë së ANRD nga parlamenti i parë më 2017 në parlamentin e dytë kombëtar rural në 2021. Aktualisht ANRD numëron 28 organizata anëtare dhe kjo anëtarësi e zgjeruar garantoj suksesin dhe përmasat e Parlamentit të dytë rural: një pjesëmarrje që kalon 600 pjesëmarrës nga të 61 bashkitë e vendit duke mbledhur njerëzit më përfaqësues në nivel vendor që njohin mirë problematikat.

“Në këto vite të funksionimit të vet ANRD në mënyrë të vazhdueshme ka arritur të marrë legjitimitet të sprovuar. E theksoj të sprovuar sepse janë jo vetëm 28 organizata anëtare, por në gjithë rrugëtimin tonë janë konsultuar në aktivetete të ndryshme deri në 400- 500 fermerë, autoritete vendore, aktorë të shoqërisë civile dhe të tjerë aktorë vendor për të formuar dhe mbajtur një pozicionim të caktuar në lidhje me qeverisjen e sektorit. Disa dokumente politikash janë përgatitur për të treguar ecurinë dhe sfidat e sektorit të cilat i kemi bërë prezente dhe janë pritur ndryshe nga institutione të ndryshme”.

Z. Hroni ndau ndër të tjera se Rrjeti si një organizatë me anëtarësi ka ngritur profilin e vet në këto vite duke ngritur kapacitete dhe advokuar, duke përfshirë aktorë të ndryshëm si shoqëria civile, fermerëve dhe aktorëve të tjerë, në mënyrë të veçantë qeverisjen vendore duke u identifikuar ndër të vetmit entitet që insiston për të lidhur qeverisjen vendore me politikat e zhvillimit. Ai ndalet për të përforcuar misionin e ANRD që qëndron për të lidhur modele dhe praktika pozitive në gjithë vendin, për identifikuar raste dhe problematika e për t'i bërë të njohura publikisht dhe për t'i lidhur me politikëbërjen. Dhe e gjithë kjo i shërben decentralizimit të vendimarrjes sa më pranë qytetarëve, ndërsa punohet për të siguruar një vendimarrje sa më të hapur, transparente, të konsultuar dhe sa më pranë autoriteteve vendore.

Ky mision për t'u përmbushur nuk është gjë e lehtë për një organizatë të shoqërisë civile, ndërsa punon për të qenë e pavarur dhe përfaqësuar interesat e komuniteteve dhe grupeve vendore dhe je i orientuar për ndërtimin e partneriteteve me institucionet.

“Rrjeti është përpjekur të ndërtojë identitetin e vet duke përfaqësuar interesat e grupeve të ndryshëm, duke ndërtuar partneritet me qeverisjen dhe duke shërbyer si mundësi shprese për grupet e papërfaqësuara të shoqërisë. Forumet rurale rajonale dhe ky parlament me pjesëmarrje kaq të lartë u japin shpresë njerëzve për të besuar, sepse disa politika mund të advokohen, disa vendimarrje mund të ndryshohen dhe kështu gjërat të vinë gjithnjë e më pranë interesave direkte të përfituesve të Ministrisë dhe AZHBR si dhe grupeve të ndryshme”.

Në përfundim të reagimit të vet, z. Hroni ndan me pjesëmarrësit objektivin e ANRD për kohën përpara mbi përpjekjet për të krijuar partneritet me Komisionin parlamentar të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisin, me qëllimin për ta pasur atë aleatin kryesor të përpjekjeve tona për të përmirësuar qeverisjen e sektorit bujqësor dhe rural dhe mbështetjen e kontributeve që vinë nga niveli vendor.

KUVENDIM NË KAFENË RURALE

- Diskutime në grupe të vogla (raundi I)

Objektivi kryesor i Kuvendimeve është eksplorimi i një çështje nga perspektiva të shumta dhe sigurimi i kontributit nga të gjithë grupet e interesit (fermerë, institucione publike, organizata të shoqërisë civile, të rinj dhe gra, grupe prodhuesish, banorë të zonave rurale etj) pjesëmarrës në Parlamentin rural, duke i angazhuar ata në dy raunde të bisedave në grupe të vogla sipas tetë tematikave.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

E WORKSHOPEVE TEMATIKE

Të jesh rural? Nevoja dhe sfida, përvoja pozitive dhe mundësi

Organizata pritëse: ADAD Malore dhe COSPE (Bashkëpunimi për Zhvillimin e Vendeve në Emergjencë)

Moderatore: Liljana Isaku, ADAD Malore

Folëse kryesore: Xhevaire Dulja, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Raportuese: Rozeta Gradeci, COSPE

Workshopi Të jesh rural? Nevoja dhe sfida, përvoja pozitive dhe mundësi ka në fokus eksplorimin e çështjeve, përvojave dhe ndjesive që lidhen me konceptin e të qenit rural, duke u përpjekur për të ofruar një pasqyrë të përgjithshme dhe tendencat bashkëkohor të të qenit rural. Cilat janë nevojat dhe sfidat me të cilat përballen komunitetet rurale, në çmënyrë ato përballohen, cilat janë mundësitë e ardhme, çfarë përvojash pozitive identifikojmë nga të qenit rural? Këto janë disa nga çështjet kryesore të diskutimit dhe pavarësisht çështjeve të ndryshme të diskutimit, pjesëmarrësit ndanë opinionione dhe përvoja në lidhje me nevojat dhe sfidat aktuale në zonat rurale. Në vijim të diskutimit, pjesëmarrësit ndanë dhe rekomandime për të mbështetur zhvillimin e ekonomisë dhe jetës në fshat.

Fuqitë/nxitësit/potencialet/mundësitë e identifikuara

Zhvillimi i sektorit të agrobiznesit ndikon pozitivisht në rivitalizimin e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural në mbarë vendin;

Agroturizmi kontribuon si në rritjen e qëndrueshmërisë së fermave bujqësore, ashtu dhe në lidhjen e peizazhit, turizmit, bujqësisë organike dhe të qëndrueshme;

Ruajtja e tokës bujqësore dhe hapësirave të gjelbra, për promovimin dhe nxitjen e zhvillimit të bujqësisë dhe zhvillimit rural;

Zonat rural përpiqen për të siguruar stabilitet dhe përshtatshmëri të fermave ekzistuese; qëndrueshmëria ekonomike e fermave do të ndihmojë në ruajtjen e qëndrueshmërisë së saj ekologjike dhe kulturore afatgjatë

Vlerësimi i bujqësisë lokale krijon vetë-zhvillim të komunitetit, dhe mundëson mbështetjen e fermerëve në burimet dhe pasuritë lokale për të përmirësuar mirëqenien e tyre ekonomike;

Difersifikimi në prodhimin e produkteve bujqësore lokale të zonës dhe promovimi i tyre në nivel kombëtar dhe më gjerë.

Konservimi i kulturës lokale, traditave që janë krijuar në shekuj si formë përshtatje dhe mbijetese, shfrytëzim miqësori i burimeve

Zonat rurale krijojnë rezerva ushqimore, ruajnë mjedisin, pejsazhin, diversifikimin e produkteve.

Sfidat/nevojat/shqetësimet

Braktisja e fshtrave shkakton mbipopullimi e disa zonave dhe qyteteve;

Mbishfrytëzimi i burimeve natyrore, rritje e presionit mbi burimet natyrore dhe mjedisin;

Moshfrytëzimi i burimeve natyrore në zonat e braktisuara duke mos krijuar vlera;

Ruajtja e tokës dhe mjedisit: keqpërdorimi i tokës bujqësore dhe ndryshimi i destinacionit të saj kryesisht ndërtime banimi dhe industrial;

Ofrimi i limituar i shërbimeve shëndetësore, arsimore, infrastrukturë dhe shërbimeve utilitare.

Keqpërdorimi i burimeve-ka humbur lidhja e fortë e banorëve të zonës si përdorues dhe roje të burimeve natyrore: shpyllëzimet që gjithsesi janë në ulje, përdorimi i ujërave, rastet e HEC-eve pa kriter dhe që nuk respektojnë standartet e vendosura;

Krijimi i infrastrukturës: rrugore, energjisë, furnizimi me ujë, telekomunikacioni

Rekomandime

- Krijimi i i tregjeve afër që fermerët të mund të tregtojnë produktet e tyre afër dhe pa kosto.
- Mbështetja e fermerëve të vegjël dhe nxitja që ata të prodhojnë për të furnizuar ekonominë lokale, agriturizmet e zonës, produktet lokale të territorit duhet të jenë të çertifikuara, si dhe të ruhen burimet natyrore dhe kulturore të zonave rurale për të shtuar ofertën turistike.
- Ofrimi i mbështetjes së vazhdueshme për fermerët e vegjël për matrikullimin e bagëtive si dhe në ndërtimin e therrtove sipas nevojave;
- Duhet mbështetur të gjithë fermerët në forma të ndryshme në mënyrë që t'u krijohen sa më shumë lehtësira për aplikime për subvencione dhe grante të formave të ndryshme;
- Investim në sistemet e vaditjes;
- Për turizmin rural duhen siguruar shërbime si energji elektrike, infrastrukturë dhe furnizim me ujë të pijshëm gjatë gjithë vitit për bujtinat dhe resortet agrituristike si dhe operatorët e turizmit rural.
- Mbrojta e fermerëve dhe produkteve të tyre; subvencionimi mbetet prioritet në mbështetjen e fermave të vogla. Viti pandemik tregoi rëndësinë që kanë në sigurinë ushqimore kombëtare.

Workshopi 2: Eksodi rural - shkak apo pasojë?

Organizata pritëse: Volontari Nel Mondo RTM dhe Aleanca e Alpeve Shqiptare

Moderator: Benito Prendi, Volontari Nel Mondo RTM

Folës kryesor: Fatmir Guri, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Raportues: Gent Imeraj, Aleanca e Alpeve Shqiptare

Me një titull që prezanton dilemën e përhershme mbi ndryshimet demografike në zonat rurale, workshopi tematik Eksodi rural - shkak apo pasojë ka në qendër të diskursit të vet eksodin rural si një fenomen global që dita ditës po bëhet më i dukshëm edhe për vendin tonë. Në sesionin e parë workshopi trajton aspekte të përgjithshme të eksodit rural si shkaqet e largimit të njerëzve nga fshati, përmasat dhe trendet e migrimit, metodologjia e frenimit të eksodit si dhe programet mbështetëse për rininë rurale. Gjatë sesionit të dytë të workshopit, në hapësirën e diskutimit pjesëmarrësit kanë mundësi të shkëmbejnë idetë e tyre për sa i përket

sfidave, nevojave dhe problemeve me të cilat ata ndeshen, duke sugjeruar e propozuar edhe zgjidhjet përkatëse.

Eksodi rural: shkaqet/sfidat/nevojat/pasojat	Eksodi rural: fuqitë/nxitësit/potencialët/mundësitë e identifikuarra për jetesën në zonat rurale
Nivel i ulët i shërbimeve publike në fshat (shkak por edhe pasojë)	Mjedisi rural miqësor dhe i qetë, jetesë e thjeshtë e pa stres, njerëz paqedashës dhe punëtorë
Pasiguria për pronësinë dëmton investimet afatgjata (shkak) dhe aplikimin në skemat mbështetëse	Diversifikim i investimeve dhe veprimtarive rurale nëpërmjet eksperimenteve të reja të fituara në emigracion
Stigma ndaj punës në bujqësi: ajo konsiderohet e vështirë, e keqpaguar dhe pëlqehet pak (shkak)	Pakësimi i popullsisë rurale zvogëlon presionin mbi burimet natyrore
Përrjashtimi nga skemat mbështetëse për mospërbushje kriteresh (shkak reliev malor copëzimi i pronave dhe largësia)	Ndikimi zbutës i skemave kombëtare edhe pse prodhuesit e vegjël në zonat rurale e kanë të vështirë përfitimin nga ato
Mundësi të pakta zhvillimi dhe kapital social i ulët (shkak por edhe pasojë)	Përqendrim i vëmendjes gjatë viteve të fundit drejt zhvillimit rural, investimet mbi fshatrat SMART
Pakësimi i popullsisë rurale zvogëlon shkallën e ekonomive bujqësore dhe efektivitetin e investimeve në zonat rurale (shkak por edhe pasojë)	Procesi i Integritimit Evropian-mbështetje ekonomive rurale nëpërmjet programit IPARD
Migrimi rural si tendencë globale	

Rekomandime

- Ofrimi i mbështetjes për fermerët e rinj për të jetësuar ide biznesi që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm rural;
- Rishikim i ligjit për dokumentacionin e tokave bujqësore dhe legalizimin e pronave për të lehtësuar aksesin e fermerëve në skemat mbështetëse;
- Promovimi i zinxhirit të vlerës në fshat si një tërësi veprimtarish, që lidhen ngushtë me jetën rurale, me synimin final nxitjen e zhvillimit.

Workshop 3: Fermerët e vegjël – Kontribut i rëndësishëm – Probleme të mëdha

Organizata pritëse: Rural Association Support Programme (RASP) dhe Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin rural (ANRD)

Moderator: Petrit Dobi, RASP

Folës kryesorë: Orion Xhoxhi, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Input teknik: Klodjan Rama, Përfaqësues i Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ)

Raportuese: Desjana Grymshi, ANRD

Workshopi tematik “Fermerët e vegjël – Kontribut i rëndësishëm – Probleme të mëdha” ka në fokus të diskutimit tre çështje kryesore : (i) rolin e fermerëve të vegjël në zhvillimin ekonomik, (ii) problemet me të cilat përballen fermerët e vegjël, dhe (iii) rekomandimet mbi mënyrat dhe mjetet për të nxitur zhvillimin rural. Nisur nga fakti që shumica e fermerëve që operojnë në fushën e bujqësisë në Shqipëri janë fermerë të vegjël (86%), kjo temë paraqet një interes të veçantë për shumë fermerë që operojnë në territorin e vendit. Ndryshe nga workshopet e tjera tematike, workshopi i tretë sjell së bashku jo vetëm pjesëmarrësit virtualë dhe tre ekspertët e angazhuar por edhe përfaqësues nga komuniteti i donatorëve – GIZ - që evidentojnë rolin e rëndësishëm që mund të luajnë donatorët (veçanërisht GIZ nëpërmjet programit Co-Solve) në rimëkëmbjen e bizneseve të vogla që operojnë në fushën e bujqësisë, përpunimit dhe më gjerë, të dëmtuara nga pasojat e pandemisë Covid-19. Më poshtë paraqiten mundësitë, sfidat dhe rekomandimet që lidhen me tematikën e trajtuar.

Fermerët e vegjël: Sfidat/ nevojat/shqetësimet

Megjithë ekzistencën e standardeve për sigurinë ushqimore, cilësia dhe siguria ushqimore vazhdon të jetë e ulët;

Ndërveprim i ulët mes fermerëve për të bashkëpunuar;

Fermerët e vegjël: Fuqitë/nxitësit/potenciallet/mundësitë e identifikuara

Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë në Shqipëri, pasi punëson 39.4% të popullsisë dhe kontribuon me 18.4% në PBB (INSTAT 2021);

Mbi 86% e fermave në Shqipëri janë ferma të vogla (0-2 ha) gjë që rrit relevancën e tyre në lidhje me fokusin e politikave dhe ndërhyrjeve nga shteti dhe donatorët; Potencial ekzistues për të shfrytëzuar teknologjinë dhe mjetet agropërpunuese të reja;

Fermerët e vegjël: Sfidat/nevojat/shqetësimet

Përfshirje e ulët e fermerëve në shërbimin këshillimor;

Kapacitete të pamjaftueshme për përdorimin e teknologjisë së integruar në prodhimet bujqësor
Problemet me zinxhirin e vlerës dhe marketingun

Inovacion i limituar dhe akses i kufizuar në finance;

Mungesën e titujve të pronësisë, pengesë për të përfituar nga skemat mbështetëse;

Informacion i limituar në lidhje me praktikat e mira që përdoren në rajon dhe më gjerë, dhe aksesin në grante;

Indicie praktikash korruptive në ofrimin e mbështetjes me grante.

Fermerët e vegjël: Fuqitë/nxitësit/potenciallet/mundësitë e identifikuara

Promovim dhe zhvillim i prodhimeve artizanale;

Potencial për të krijuar dhe absorbuar vlerë të shtuar;

Fermerët e vegjël janë në fokus të skemave mbështetëse si ato kombëtare ashtu dhe të programit IPARD;

Ka interes për diversifikimin e produkteve lokale që prodhohen në nivel ferme dhe promovimin e tyre në nivel kombëtar dhe më gjerë;

Zhvillimi i sektorit të turizmit shihet si një mundësi që jo vetëm nxit vepërimtarinë ekonomike por në të njëjtën kohë nxit edhe konsumin e prodhimeve bujqësore;

Lidhje organike e turizmit rural, agroturizmit dhe zhvillimit rural;

Fermerët e vegjël kanë rendimente më të larta për produktet që kërkojnë punë intensive (produkte me vlerë të lartë)

Rekomandime

- Fuqizimi i kapaciteteve për mbështetjen e të rinjve në zonat rurale;
- Ndërgjegjësim mbi cilësinë dhe sigurinë e produkteve bujqësore;
- Fuqizimi i kapaciteteve zhvillimore për prodhuesit në zonat rurale;
- Nxitja e formimit profesional dhe krijimi i sipërmarrjeve të reja;
- Zhvillimi i sektorit të turizmit, aplikimi i zinxhirit të shkurtër të vlerës;
- Promovimi i traditës lokale përmes produkteve bujqësore lokale;
- Ofrimi i skemave mbështetëse të bashkive sipas prioriteteve territoriale;
- Menaxhim më eficient i burimeve natyrore dhe atyre ujore;
- Rritja e bashkëveprimit midis prodhuesve dhe tregtarëve;
- Forcimi i rrjeteve dhe bashkëpunimit mes fermerëve të vegjël.

Workshop 4: Roli i Bashkive në zhvillimin e zonave rurale

Organizata pritëse: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe Klubi i Sipërmarrësve të Rinj

Moderatore: Lorena Totoni, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Folës kryesor: Agron Haxhimali, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Raportues: Denis Lushi, Klubi i Sipërmarrësve të Rinj

Reforma Administrative-Territoriale dhe kuadri ligjor që e pasoi (Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”) u akordoi bashkive kompetenca të reja në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Ekspertë të fushës, përfaqësues të pushtetit vendor, komuniteteve rurale e shoqërisë civile diskutojnë gjatë workshopit tematik Roli i Bashkive në zhvillimin e zonave rurale për të hedhur dritë sesa afër apo larg realitetit rural janë këto kompetenca dhe identifikuar sfidat e oportunitetet për ushtrimin efektiv të tyre. Diskutimet përqendrohen rreth qasjes aktuale të bashkive në raport me zhvillimin rural, programet mbështetëse të financimit si dhe përfshirjen e komunitetit në hartimin e politikave vendore të zhvillimit rural. Më poshtë janë pasqyruar sfidat, mundësitë dhe rekomandimet e identifikuara gjatë këtij ëorkshopi tematik.

Sfidat/nevojat/shqetësimet	Fuqitë/nxitësit/potencialet/mundësitë e identifikuara
Kapacitete e burime të limituara të bashkive për të zbatuar kërkesat e ligjit, vullnet i pakët i drejtuesve vendore	Kuadri ligjor përcakton qartë rolin dhe detyrat e bashkive për zhvillimin bujqësor dhe rural
Bashkitë përballen me vështirësi në komunikimin dhe ndërveprimin me fermerët dhe bizneset	Burime natyrore të mjaftueshme për të sjellë një impakt pozitiv në zhvillimin e komuniteteve rurale nëse përdoren me efektivitet
Shpërndarje jo uniforme e investimeve midis zonave urbane/rurale në planet e zhvillimit vendor	Asete të trashëgimisë kulturore dhe natyrore si potenciale për zhvillimin e turizmit rural
Investime të pamjaftueshme në infrastrukturën e zonave rurale nga ana e bashkive	Programe të mira që kanë qëllim të mbështesin zhvillimin rural, edhe pse pa impakt të qenësishëm, p.sh Programi i 100 Fshatrave

Sfidat/nevojat/shqetësimet	Fuqitë/nxitësit/potencialet/mundësitë e identifikuar
Nivel i ulët i iniciativave të bashkive për promovimin/marketingun e sipërmarrjeve rurale	Rritja e vazhdueshme e iniciativave për lidhjen e komuniteteve me kulturën dhe tokën bujqësore në zonat rurale
Informacion i pakët për skemat e subvencioneve dhe granteve, menaxhim jo efektiv i tyre, mungesë meritokracie në përzgjedhjen e fituesve	
Reagim i ulët kundrejt sugjerimeve / kërkesave e problemeve që ngrenë grupimet rinore, mungesë e politikave të mirëfillta vendore për punësimin e tyre që sjellin largimin e të rinjve dhe mungesën e motivimit të tyre për tu rikthyer	

Rekomandime

- Fuqizimi i bashkive me kompetenca, akte nënligjore etj, për të mbështetur zhvillimin rural e bujqësor;
- Krijimi i fondit vendor për mbështetje ndaj fermerëve që nuk kanë akses tek skemat kombëtare;
- Ndërhyrje përmirësuese të bashkive në infrastrukturën, shërbimet dhe platformat e komunikimit të zonave rurale;
- Procese me pjesëmarrje të gjerë informimi dhe konsultimi publik në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural;
- Promovim i aktiviteteve të agrobizneseve si një aset i rëndësishëm për bujqësinë dhe zhvillimin rural;
- Angazhim më i madh i zyrave të informimit dhe punësimit për profesionistët e rinj;
- Fuqizimi i tregut të brendshëm dhe krijim i lehtësirave për aksesin e fermerëve;
- Hartimi dhe implementimi i projekteve që nxisin punësimin e të rinjve;
- Krijimi i programeve të kreditimit me interesa të pranueshme për bizneset e reja rurale;

- Një planifikim dhe raport shpërndarje më i drejtë për investimet në zonat urbane dhe rurale;
- Krijimi i skemave të granteve lokale për bizneset start-up dhe fermerët në zonat rurale;
- Krijimi i zërit buxhetor dedikuar për gratë rurale në buxhetet e bashkive.

Workshopi 5: Bujqësia dhe zhillimi rural në kontekstin e sfidave të fatkeqësive natyrore

Organizata pritëse: Instituti i Bujqësisë Biologjike (IBB) dhe Agro Puka

Moderator: Enver Isufi, IBB

Folës kryesor: Shpresim Domi, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Raportues: Vitor Malutaj, Agro Puka.

Në kushtet e incidencës së lartë të fatkeqësive natyrore, (vendi ynë brenda një hapësire kohore dy-vjeçare është goditur nga një numër fatkeqësish natyrore madhore si tërmete, pandemi etj.,) ka rëndësi të bëhet i njohur impakti i tyre mbi zhvillimin social e ekonomik të komuniteteve të prekura rurale. Në këtë kuadër, objektivi kryesor i workshopit Bujqësia dhe zhvillimi rural në kontekstin e sfidave të fatkeqësive natyrore është të ofrojë një analizë të thelluar në lidhje me ndikimin e fatkeqësive natyrore në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Duke nënvizuar rëndësinë e qasjes proaktive, një pjesë e rëndësishme e workshopit fokusohet gjithashtu në dhënien e rekomandimeve mbi menaxhimin sa më efektiv të sfidave dhe fatkeqësive natyrore për të mundësuar minimizimin e kostove për komunitetet rurale dhe ekonomitë e tyre.

Sfidat/nevojat/shqetësimet	Fuqitë/nxitësit/potencialet/mundësitë e identifikuara
Shkalla e ulët e ekonomive bujqësore, kostoja e lartë e prodhimit, aksesit i kufizuar në treg, informaliteti dhe fragmentarizimi i tokave ulin resiliencën ndaj fatkeqësive natyrore	Bujqësia është një sektor i rëndësishëm në nivel kombëtar duke dhënë 18.4% të PBB dhe ka potencial të lartë zhvillimi
Programim dhe financime të pamjaftueshme për përballimin e fatkeqësive natyrore	Ende një pjesë e konsiderueshme e popullsisë, jeton në zonat rurale

Sfidat/nevojat/shqetësimet	Fuqitë/nxitësit/potencialet/ mundësitë e identifikuara
Lidership i fragmentarizuar institucional për reagimin proaktiv dhe menaxhimin e pasojave të fatkeqësive natyrore	Zhvillimi global lehtëson rrjetëzimin dhe përdorimin e inovacionit dhe qasjeve smart për përballimin fatkeqësive natyrore
Diversifikimi i limituar bën që aktivitetet bujqësore të jenë burim kryesor ose i vetëm i të ardhurave dhe jetesës për një pjesë të konsiderueshme të popullsisë rurale	Programe mbështetëse dhe kontribut nga donatorët për përballimin e pasojave

Rekomandime

- Pëfshirje në dialog dhe advokaci për hartimin e një kuadri strategjik dhe ligjor të qëndrueshëm për përballimin e fatkeqësive natyrore;
- Bashkëpunim dhe koordinim i vazhdueshëm midis niveleve të ndryshme vendimmarrëse dhe institucionale;
- Edukim, ndërgjegjësim dhe trajnim i vazhdueshëm për popullatën për përballimin e fatkeqësive natyrore, duke i përfshirë edhe në kurrikulat arsimore;
- Pjesëmarrje në programet e përbashkëta rajonale, evropiane dhe deri në ato globale për parandalimin, reduktimin dhe menaxhimin e fatkeqësive/katastrofave natyrore në vend;
- Promovim dhe rritje e ndërgjegjësimin të fermerëve për varietete e raca autoktone dhe të qëndrueshme ndaj kushteve klimaterike të vendit tonë dhe sëmundjeve të ndryshme;
- Rritja e vazhdueshme e ndërgjegjësimin të fermerëve për të siguruar prodhimet e tyre;
- Mbështetje dhe subvencionim përmes skemave të mbështetjes kombëtare të ofruara nga organet kompetente dhe donatorët për sigurimin e prodhimeve bujqësore të fermerëve;
- Qasje proaktive për planifikimin dhe realizimin e masave paraprake para ndodhjes së katastrofave natyrore, me qëllim minimizimin e ndikimeve të tyre në komunitetet rurale;
- Shfrytëzimi i ekspertizës, kapaciteteve, burimeve dhe informacionit në të gjithë rajonin (Ballkan) dhe bashkëpunim me qendra të ndryshme rajonale në Evropë dhe më gjerë;
- Digjitalizimi i bujqësisë dhe përdorimi efikas i teknologjisë dhe sistemit të të dhënave.

Workshopi 6: Bashkimi Evropian për zonat rurale – Çfarë na mëson përvoja e deritanishme me Programin IPARD II?

Organizata pritëse: Creative Business Solution (CBS)

Moderator: Grigor Gjeçi, Autoriteti Menaxhues i IPARD II në Ministrinë e Bujqësisë

Folës kryesorë: Saimir Musta, Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR)

Raportues: Ergent PIRE, CBS

Workshopi tematik BE për zonat rurale – Çfarë na mëson përvoja e deritanishme me Programin IPARD II? është fokusuar në promovimin dhe prezantimin e përvojës së deritanishme të Programit IPARD II. Workshopi përmban një qasje ndërdisiplinore, që mbështetet si në eksperiencën e deritanishme të Programit IPARD II ashtu edhe në impaktin e tij në zhvillimin e sektorit. Me qëllim prezantimin e përvojës së suksesshme të zbatimit të Programit IPARD II në fuqizimin e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural të qëndrueshëm, gjatë workshopit identifikohen potencialet, sfidat dhe nevojat për promovimin e momentumit pozitiv të krijuar në sektor nga zbatimi i këtij programi. Përveç të tjerave, workshopi ka si objektiv kryesor informimin mbi mënyrën se si fermerët mund të aksesojnë Programin IPARD II. Në fund të workshopit paraqiten edhe rekomandimet përkatëse për t'u pasur në konsideratë për implementimin e Programeve IPARD në të ardhmen.

Sfidat/nevojat/shqetësimet	Fuqitë/nxitësit/potencialet/mundësitë e identifikuara
Mungesa e titujve të pronësisë pengon dhe vështirëson aksesin e fermerëve në skemat mbështetëse	Programi IPARD III starton në Janar 2022 me një fond prej rreth 160 milionë Euro duke vazhduar mbështetjen për investime në nivel ferme, agropërpunim dhe diversifikim të aktiviteteve në zonat rurale
Vonesa në aprovimin e lejeve të ndërtimit dhe lëshimin e liçensave për fermerët	Rritje e mbështetjes për prodhimin dhe përpunimin e bimëve medicinale në masën 1 dhe masën 3
Vështirësi në shitjen e produkteve bujqësore për shkak të mungesës së tregjeve	Përfshirje në skemat e mbështetjes të sektorit të ullirit dhe vajit të ullirit

Sfidat/nevojat/shqetësimet

Fuqitë/nxitësit/potencialet/ mundësitë e identifikuara

Shtimi i masave të reja mbështetëse për mbrojtjen e mjedisit, mbështetjen e bujqësisë organike, produktet autoktone, zbatim i qasjes LEADER, mbështetje për infrastrukturën rurale, asistencë teknike për ngritjen e kapaciteteve të shërbimit të ekstensionit

Rekomandime

- Futja në prioritetet e qeverisë e kuadrit lehtësues për azhurnimin e tokave bujqësore dhe lëshimin e titujve të pronësisë për zgjerimin e hartës së përfituesve nga Programi IPARD III;
- Krijimi dhe ofrimi i incentivave konkrete për formalizimin e agrobizneseve dhe fermave si domosdoshmëri për përfitimin e mbështetjes nga programi IPARD III;
- Lehtësimi dhe përsheptimi i procedurave për marrjen e lejeve të ndërtimit dhe liçensave përkatëse për investime me ndikim të lartë në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural;
- Koordinim i vazhdueshëm midis institucioneve të përfshira në lëshimin e dokumentave ligjore dhe tatimore për aplikantët do të lehtësonte procedurat dhe rriste cilësinë e aplikimeve të fermerëve.

Workshopi 7: Inovacioni, teknologjia dhe burimet njerëzore (kërkimi shkencor, dixhitalizimi që mbyll hendekun fshat-qytet, mekanizimi dhe teknologjia, informacioni dhe shkëmbimi)

Organizata pritëse: Gratë në Bujqësinë e Qëndrueshme dhe Agrinet

Moderatore: Tatjana Dishnica, Gratë në Bujqësinë e Qëndrueshme

Folës kryesor: Edvin Zhllima, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Input teknik: Roland Cela, Përfaqësues i Shoqëris Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Raportues: Nikolin Karapanço, Agrinet

Workshopi tematik Inovacioni, teknologjia dhe burimet njerëzore (kërkimi shkencor, dixhitalizimi që mbyll hendekun fshat-qytet, mekanizimi dhe teknologjia, informacioni dhe shkëmbimi) përpiqet të ofrojë një analizë gjithëpërfshirëse në lidhje me fushat dhe kapacitetin e kërkimit shkencor në vendin tonë, nevojat dhe potencialin e këtij sektori, kapacitetin e shërbimeve këshillimore si dhe fushat e veprimit dhe shtrirjen e kontributit dhe asistencës së BE dhe donatorëve të tjerë në të. Në këtë kontekst në kuadër të asistencës së ofruar nga GLZ, prezantohet në formën e inputit teknik një material rreth Sistemit të Integruar të Njohurive dhe Inovacionit (AKIS) në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural me synim informimin e fermerëve dhe palëve të tjera të interesit në lidhje me shërbimet dhe zgjidhjet inovative në fushën e zhvillimit bujqësor dhe rural. Në fund workshopi përqendrohet në dhënien e rekomandimeve se çfarë mund të përmirësohet në drejtim të inovacionit, teknologjisë dhe burimeve njerëzore në mënyrë që të ketë progres në prezantimin e AKIS në Shqipëri.

Sfidat/nevojat/shqetësimet	Fuqitë/nxitësit/potencialet/ mundësitë e identifikuara
<p>Problemet e fermerëve për arritjen e një konkurrueshmërie të lartë dhe shtrirjen në tregje lidhen me :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ndryshime të shpejta në teknologji në nivel global 2. Sigurimin e prodhimeve që plotësojnë standartet e sigurisë ushqimore 3. Informacione të pakta mbi zhvillimet e sektorit dhe inovacionin 	<p>Angazhim i ANRD në procese të hapura dialogu dhe advokacie me pjesëmarrje, si dhe rrjetëzimi për shkëmbim informacioni dhe njohurie.</p> <p>Përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin e aktorëve të ndryshëm të interesit për rëndësinë e kërkimit dhe inovacionit në mbarëvajtjen e sektorit të zhvillimit bujqësor dhe rural</p>
<p>Informacionet e pakta mbi zhvillimet e sektorit dhe inovacionin ndikojnë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shitjen e ulët të produkteve • kostot e larta të prodhimit • mosnjohjen e tregut 	<p>Përpjekje pozitive për të përmirësuar, komplementaritetin e fondeve dhe rritur përfitimin nga sinergjitë dhe iniciativat në sektor</p>
<p>Koordinim i pamjaftueshëm mes aktorëve të zhvillimit bujqësor dhe rural</p>	<p>Krijimi i hapësirave për rrjetëzim e pjesëmarrje në projekte interaktive inovative, pjesë të platformave apo fondeve ndërkombëtare, rajonale</p>

Sfidat/nevojat/shqetësimet	Fuqitë/nxitësit/potencialet/ mundësitë e identifikuara
Zhvillim i pamjaftueshëm i rrjeteve të grumbullimit dhe tregimit të produkteve bujqësore	Hartimi i një mase për të mbështetur/financuar shërbimet mbështetëse inovative nëpërmjet një skeme granti me target të caktuar për institucionet kërkuese apo ato këshilluese
Kapacitete të ulta për përshtatjen ndaj ndaj ndryshimeve klimatike	QTTB -të janë institucione me mbi 50 vjet ekzistencë, ato janë ngritur në zona tipike të zhvillimit bujqësor, kanë ndarje territoriale sipas tipizmit të zonave dhe kanë mundësi të mëdha zhvillimi
Angazhim dhe vullnet politik i pamjaftueshëm	

Rekomandime

- Procese të hapura dialogu dhe advokacie me pjesëmarrje për të nxitur përfshirjen e AKIS si pjesë integrale të Strategjisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2021-2027 si edhe për të rritur ndërgjegjësimin e komuniteteve rurale dhe fermerëve mbi përdorimin e tyre;
- Prezantimi i AKIS-Sistem i Njohurive dhe Inovacionit në bujqësi të bazuar në kërkimin shkencor dhe që në qendër të tij ka fermerin dhe sfidat e tij;
- Ndjekja e udhëzimeve dhe praktikave më të mira që ofron Politika e Përbashkët Bujqësore dhe vendet evropiane;
- Përmirësimi i kuadrit institucional dhe administrative;
- Rritja e kapaciteteve dhe aftësive të shërbimit këshillimor;
- Përmirësimi i kapaciteteve rrjetëzuese dhe koordinuese të aktorëve të zhvillimit rural lidhje me AKIS;
- Alokimi i burimeve financiare të mjaftueshme për mbështetjen e ngritjes dhe aksesimit të AKIS.
- ANRD mund të ofrojë ekspertizë si dhe mundësira rrjetëzuese dhe hapësira shkëmbimi ndërmjet aktorëve të interesit të AKIS për të nxitur inovacionin dhe kërkimin në bujqësi dhe zhvillimin rural.

Workshopi 8: Zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti - Dinamikat e zbatimit të qasjes LEADER dhe e ardhmja

Organizata pritëse: Volontariato Internazionale per lo Sviluppo (VIS Albania) dhe Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA)

Moderatore: Anna Carboni, VIS Albania

Folës kryesor: Roland Bardhi, MADA

Raportuese: Etleva Dashi, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Workshopi tematik Zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti - Dinamikat e zbatimit të qasjes LEADER dhe e ardhmja përqendrohet në rolin e pazëvendësueshëm të zbatimit të qasjes LEADER në fuqizimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Workshopi fokusohet në idenë se zhvillimi lokal i drejtuar nga komuniteti (CLLD) është një mjet për përfshirjen e aktorëve lokalë në zhvillimin e përgjigjeve ndaj sfidave sociale, mjedisore dhe ekonomike me të cilat komunitetet rurale përballen sot. Çështjet kryesore të diskutimit përqendrohen në identifikimin e kuadrit ligjor e institucional të qasjes LEADER, evolucionin e saj në BE, rëndësinë e ngritjes dhe konsolidimit të Grupeve lokale të veprimit (GLV-ve) si dhe hartimin e strategjive të zhvillimit lokal si domosdoshmëri për të ardhmen e komuniteteve rurale.

Sfidat/nevojat/shqetësimet	Fuqitë/nxitësit/potencialet/mundësitë e identifikuar
Mos zbatimi i masës LEADER në kuadër të programit IPARD II	Zbatimi i qasjes poshtë-lart dhe me pjesëmarrje një mundësi e mirë për zhvillimin e komuniteteve rurale
Kuadër ligjor i pakonsoliduar (ligji për GLV-të ende i pamiratur, GLV-të aktuale kanë statusin e OJQ-ve)	Ngritja e strukturës lehtësuese pranë MBZHR (Agjencia e Pagesave)
Mungesa e fondeve për zbatimin e qasjes LEADER	Interesim i institucioneve evropiane për politikën e zhvillimit rural në Shqipëri
Numër i kufizuar strukturash partneriteti funksional	Ndarja e re territoriale në përputhje me nomenklaturën e BE, rrit mundësitë për përfitime nga Fondet e Kohëzimit
Eksperiencat e LEADER në Shqipëri të ndërtuara në bazë projektesh dhe jo mbi një platformë të qëndrueshme afatgjatë	Shtirja dhe forcimi i bashkëpunimit shoqëri civile, akademi, institucione qendrore, komunitete vendore (ANRD-UBT-MBZHR- -komunitetet rurale) në nivel lokal krijon premisa për një zbatim të suksesshëm të LEADER në nivel kombëtar

Sfidat/nejvojat/shqetësimet	Fuqitë/nxitësit/potencialet/mundësitë e identifikuara
Braktisje e zonave rurale dhe nivel i ulët i kapitalit social	Zhvillimi i zonave potenciale, zhvillimi i turizmit e agroturizmit, zhvillimi i artizanatit, zbulimi i traditës nëpër rajone për përmirësimin e produkteve lokale dhe krijimin e zinxhirit të vlerës
Mungesë aftësish në shkrimin dhe zbatimin e projekteve të sukseshme	Angazhimi i grave dhe të rinjve ruralë në vendimarrje
Mungesa e bashkëpunimit dhe bashkëndimi mes aktorëve të ndryshëm vendor	Rritja e mundësive të punësimit në zonat rurale
Kapital i ulët social në nivel vendor	<p>Aplikimi i dy programeve të studimit :</p> <p>Agjent i Zhvillimit Lokal (AZHL) në Shqipëri i cili ka për qëllim kualifikimin profesional të grupeve të veprimit lokal</p> <p>Master ekzekutiv në “Planifikim dhe zhvillim territorial” që do të ndikojë pozitivisht në nivelin politik-bërës</p>
Lidership i ulët institucional nga ana e MBZHR për promovimin e qasjes Leader.	Asistenca e planifikuar në kuadër të programit IPARD
Kapacitete të kufizuara të aktorëve të ndryshëm vendor mbi instrumentin e qasjes LEADER;	Përvoja të mëparshme të zbatimit të qasjes në Leader në Shqipëri; ekspozimi i një numri të konsiderueshëm aktorësh me njohuritë dhe praktikat për qasjen LEADER
Mungesa e vullnetit politik për të adoptuar qasjen LEADER si instrument efektiv për zhvillimin e intergruar rural	ANRD po kthehet në një qendër burimore kombëtare për qasjen LEADER; materiale informuese dhe promovuese si dhe kapacitete njerëzore të trajnuar në zbatimin e qasjes.

Rekomandime

- Rritja e ndërgjegjësimit të komuniteteve lokale mbi mundësitë zhvillimore që ofron qasja LEADER;
- Krijimi i një harte me territoret e LEADER dhe GLV-të;
- Konsolidimi i partneritetit afatgjatë midis aktorëve të qasjes LEADER duke forcuar bashkëpunimin me aktorët e pushtetit vendor;
- Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD) ka potencialin të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve vendore ku përfshihen ekipet e specializuara të ekspertëve për vlerësimin, seleksionimin, supervizionin dhe kontrollin e projekteve që do të aprovohen nën strategjitë e zhvillimit lokal;
- Të përmirësohet dialogu dhe komunikimi midis aktorëve të zhvillimit rural me pjesëmarrje në dobi të identifikimit të prioritetëve, nevojave, ideve dhe mundësive të bashkëpunimit, për gjetjen e zgjidhjeve afatgjata për një zhvillim të qëndrueshëm të komuniteteve rurale
- Hartimi dhe zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal;
- Shmangia e përsëritjes së gabimeve nga projektet ekzistuese;
- Advokaci dhe dialog politik për të përshpejtuar proceset reformuese të sektorit, përfshi dhe qasjen Leader, drejt praktikave dhe mdeleve pozitive evropiane.



SESION PLENAR & PËRSHENDETJE NGA MIQTË E PARLAMENTIT RURAL SHQIPTAR

Thorben Kruse – Lider i komponentit Bujqësia dhe Zhvillimi Rural – Projekti SRD, GIZ

Duke shprehur kënaqësinë për mbështetjen e këtij eventit nga GIZ, z. Kruse u përqëndrua fillimisht tek problematika e produkteve organike vendase duke e vendosur theksin tek rritja e sasisë, përpunimit dhe eksportit të tyre veçanërisht përsa i përket bimëve mjekësore dhe aromatike duke adoptuar si standarde minimale ato të BE-së. Më pas Lideri i komponentit u fokusua tek përmirësimi i cilësisë dhe konkurrueshmërisë së produkteve tradicionale vendase si një burim i rëndësishëm të ardhurash për komunitetet rurale.

Një moment tjetër i diskutimit të tij ishte evidentimi i nevojës për koordinim të planeve dhe ndërhyrjeve të donatorëve në nivel kombëtar, koordinim që duhet të shtrihet edhe në nivelin lokal për të rritur efektivitetin e këtyre ndërhyrjeve dhe shmangien e mbivendosjeve. Gjithashtu një çështje relevante u konsiderua edhe njohja dhe promovimi i sistemit AKIS nga fermerët e veçanërisht ngritja e grupeve lokale të veprimit me fokus këtë sistem që do të ndikojë në rritjen e konkurrueshmërisë së aktiviteteve të tyre.

z. Kruse në fjalën e vet u përqëndrua në procesin e asistencës së ofruar nga GIZ për MZHBR përsa i përket hartimit të dokumentit të Strategjisë së re për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, dokument i cili duhet të hartohet me kontributin e banorëve të zonave rurale nëpërmjet proceseve aktive të konsultimit publik.

“Strategjia e re për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural duhet të prekë ata që jetojnë e punojnë në zonat rurale. Është shumë e rëndësishme t’i kesh me vete këta njerëz, të thithësh mendimet e tyre për strategjinë dhe të ndërtosh një proces konsultimi ashtu siç duhet në të gjitha nivelet”.

Duke iu referuar sesionit të të rinjve në Parlamentin Rural, z. Kruse theksoi rolin e rëndësishëm të tyre për të ardhmen e ekzistencës së zonave rurale.

“Jam shumë i lumtur që çështja e të rinjve po trajtohet kaq seriozisht nga Parlamenti Rural sepse të gjithë duhet ta kemi të qartë se pa praninë e të rinjve, nuk ka të ardhme për zonat rurale. Prandaj theksoj me forcë që të rinjtë duhet të ndihmohen që të krijojnë kushtet dhe mjedisin e përshtatshëm për një jetë dinjitoze në zonat rurale”.

Në fund, duke adresuar problemin e ndikimit negativ të pandemisë COVID-19 në zonat rurale dhe aktivitetin ekonomik të banorëve të tyre, z. Kruse bëri prezantimin e programit CoSolve, një program bashkëpunimi i GIZ me Qeverinë Shqiptare që synon zbutjen e ndikimit të pandemisë dhe rigjallërimin e komuniteteve rurale të dëmtuara nga efektet e saj.

Eglantina Gjermani, Deputete e Kuvendit të Shqipërisë, anëtare e Grupit të Miqve të Parlamentit Rural Shqiptar

Fillimisht zj. Gjermani shprehu entuziazmin e saj për organizimin e këtij eventit edhe në kushtet e pandemisë, duke vlerësuar punën e organizatorëve dhe angazhimin si dhe interesin e treguar nga të gjithë pjesëmarrësit në lidhje me kauzën e zhvillimit të qëndrueshëm rural. Ajo e cilësoi Parlamentin si një mjet të fuqishëm advokacie për evidentimin e problemeve të zonave rurale, sigurimin e mbështetjes për fermerët dhe gratë rurale si edhe për të gjetur zgjidhje për problematikat e tyre.

“Mendoj që nisma e Parlamentit Rural meriton konsiderata maksimale. Është mënyra më e mirë për të bërë advokaci, për të nxjerrë në pah problematikat më të cilat përballen zonat rurale e në mënyrë të veçantë gratë dhe vajzat rurale, por edhe për të kërkuar mbështetje dhe zgjidhje për një sërë çështjesh”.

Në lidhje me ndihmesën e ofruar nga GIZ për zonat rurale të prekura nga pasojat e pandemisë nëpërmjet programit CoSolve, zj. Gjermani vlerësoi gatishmërinë për bashkëpunim të donatorëve gjermanë si edhe ndihmesën e të gjithë donatorëve të tjerë që kanë në fokus zhvillimin rural dhe fuqizimin e komuniteteve rurale e veçanërisht grave rurale, si UN Women, FAO, AICS etj. Në kuadër të çështjes së fuqizimit të grave rurale, ajo nënvizoi arritjet në këtë fushë duke përmendur rritjen e përfaqësimit të grave në

politikë pa harruar edhe sfidat që mbeten për t'u përballuar: fuqizimin e mëtejshëm ekonomik të grave si një problem, zgjidhja e të cilit parandalon edhe shumë probleme të tjera sociale si dhuna në familje, trafikimi, feminizimi i varfërisë etj.

Duke iu referuar përvojës së saj, Zj. Gjermani evidentoi rolin e jashtëzakonshëm që gratë rurale luajnë në jetën sociale-ekonomike të vendit duke vërejtur nga ana tjetër që shpesh ky kontribut nuk njihet dhe vlerësohet sa duhet nga shoqëria shqiptare. Në këtë kontekst Zj. Gjermani kërkoi rritjen e bashkëpunimit dhe maksimizimin e përpjekjeve të shoqërisë civile, strukturave shtetërore e donatorëve ndërkombëtare në dobi të njohjes, mbështetjes dhe kapitalizimit më të mirë të këtij kontributi në mënyrë që vajzat dhe gratë rurale të dalin nga cikli i varfërisë duke shërbyer si model edhe për gratë e vajzat e tjera. Zj. Gjermani gjithashtu vlerësoi dëshirën për të ecur përpara të grave rurale, kurajon dhe guximin e tyre, edhe pse shpesh në kushte mungese të mjeteve dhe shërbimeve bazë, si edhe aftësitë e tyre sipërmarrëse që i kanë shndërruar ato në modele të vërteta suksesi që duhen njohur e promovuar.

Më pas Zj. Gjermani u ndal në mbështetjen ndaj grave rurale, ku përmendi përpjekjet advokuese për politika që nxisin rritjen e numrit të grave rurale që përfitojnë nga skemat mbështetëse nëpërmjet vendosjes së kritereve përfshirëse për gjininë, statusin social, izolimin gjeografik, situatën e gjakmarrjes etj. Ajo vlerësoi përpjekjet e grave rurale për t'u përfaqësuar politikisht si një mënyrë e drejtpërdrejtë për të ngritur zërin dhe kërkuar zgjidhje për problemet e zonave rurale. Ajo theksoi se zhvillimi i Parlamentit të Dytë Rural Kombëtar para zgjedhjeve qendrore, krijon momentin e përshtatshëm për një proces energjik advokacie dhe lobimi për integrimin e problematikave rurale me programet e kandidatëve dhe partive politike konkurruese. Duke vlerësuar edhe një herë eventin, mikja e parlamentit rural bëri thirrje që aktorët e zhvillimit bujqësor dhe rural të përfitojnë nga outputet dhe momentumet e krijuar nga Parlamenti i Dytë Rural për ndërtimin e politikave dhe praktikave më të mira me pjesëmarrjen dhe në dobi të mirëqenies së banorëve të zonave rurale.

Rigerta Loku, fermere, anëtare e Grupit të Miqve të Parlamentit Rural Shqiptar

Në fjalën e saj Znj. Loku bëri një krahasim të gjendjes së fermerëve nga Parlamenti i parë rural në parlamentin e Dytë Rural. Duke iu referuar thirrjeve të saj emocionale në parlamentin e parë për më shumë vëmendje për fshatin, Zj. Loku vërejti me zhgënjim se pak gjëra kanë ndryshuar nga ajo kohë.

Duke sjellë fakte mbi rëndësinë e sektorit të bujqësisë e zhvillimit rural për ekonominë e vendit, ajo vuri në dukje kontrastin që ekziston midis kësaj rëndësie dhe mbështetjes që shteti ofron për sektorin, e cila renditet si më e ulëta në rajon. Zj. Loku nënvizoi se kjo mbështetje dhe politikat që e gjenerojnë atë nuk janë të bazuara në konsultimin me fermerët e thjeshtë në terren dhe nuk përfaqësojnë interesat e tyre, duke qenë të paqëndrueshme e duke duke shënuar mospërputhje me realitetin bujqësor dhe rural. Gjithashtu ajo shtoi se monitorimi i vazhdueshëm në terren i fermerëve, rrjetezimi, komunikimi, këshillimi, inovacioni, marketingu e informacioni, nuk janë bërë pjesë integrale e realiteteve rurale. E njëjta gjë mund të thuhet për kreditimin e fermerëve të vegjël e të mesëm si edhe fuqizimin e grave rurale që kanë një rol të vështirë por domethënës në zhvillimin rural. Ajo theksoi se është emergjente të krijohet infrastruktura e nevojshme për lehtësimin e jetesës së familjes e sidomos të grave rurale që janë aktore të rëndësishme të zhvillimit e përparimit në fshat.

Zj. Loku bëri thirrje për marrjen e masave që ndalojnë hemoragjinë e eksodit rural duke lehtësuar punën e jetesën e banorëve që kanë mbetur në fshat. Këtu përmendi nevojën për politika ekonomike proteksioniste për produktet kombetare. Ajo gjithashtu vlerësoi se mbështetja financiare dhe rritja e atraktivitetit të jetesës e punës në fshat do të shërbente forcimit të kapitalit njerëzor në zonat rurale. Duke ngritur zërin mbi mungesën e hallkave të zinxhirit të vlerës si tregjet dhe ambientet e tjera të nevojshme për ruajtjen dhe përpunimin e produkteve, ajo nuk harroi tu bënte thirrje komuniteteve rurale për tu ndërgjegjësuar për rëndësinë e tyre në proceset politikëbërëse, vendimmarrëse dhe fatet e rajoneve të tyre në përgjithësi.

“Atyre që kanë mbetur në fshat t’ua lehtësojmë punën dhe ta bëjmë zhvillimin rural atraktiv për të investuar dhe pse jo ta kthejmë braktisjen në pikë force. Kjo hemoragji njerëzore prej zonave rurale ndalet vetëm duke i dhënë rëndësinë e duhur zhvillimit rural. Ndryshimet e vërteta do të vijnë atëherë kur ne dhe ju ta kuptojmë që Ne jemi shumë më të rëndësishëm se sa ju, që pushteti e shteti duhet t’i shërbejnë fshatit, qytetit, Shqipërisë dhe jo e kundërta”.

Duke iu referuar pandemisë globale, ajo theksoi se pandemia i dha më tepër jetë fshatit por nuk arriti ta rijetësonte atë edhe sepse shteti nuk i mbështeti komunitetet rurale për të përballuar pasojat e saj qoftë më masa direkte ashtu edhe me fonde sigurimi për përballimin e fatkeqësive natyrore. Ajo solli shembuj konkretë për të ilustruar nevojën imediate që komunitetet rurale kanë për mbështetje në fushat e sipërpërmendura. Gjithashtu ajo u ndal në problemet konkrete që lidhen me qeverisjen e sektorit të zhvillimit bujqësor dhe rural në Shqipëri duke përmendur çështjet e mungesës së transparencës, fenomeneve të vërejtura të korrupsionit në lidhje me zinxhirin e vlerës dhe aksesit në treg etj. Një qasje

kritike konstruktive pati ajo edhe duke ju referuar veprimtarisë së AZHBR në lidhje me fondet e IPARD duke kërkuar më shumë transparencë, ndërveprim me fermerët dhe infomacion. Në fund, edhe pse duke nënvizuar vështirësitë edhe sfidat, zj. Loku shprehu vendosmërinë për të qëndruar dhe punuar në fshat dhe bëri thirrje për më shumë ndihmë dhe vëmendje për fshatin.

SESION PLENAR: TË RINJTË NË ZONAT RURALE NË UDHËKRYQ

Debati i të rinjve: Të qëndrosh apo të largohesh nga fshati

Debati i të rinjve është një debat i strukturuar dhe do të jetë instrumental që të rinjtë të eksplorojnë arsyet pas migrimit të tyre nga zonat rurale, të ushtrojnë zërin e tyre dhe të ofrojnë këndvështrim pozitiv mbi shqetësimet dhe perspektivat e të rinjve.

Sesioni plenar synon të kuptojë dhe shpjegojë situatën aktuale të rinisë rurale (nevojat, sfidat dhe përparësitë) si dhe aspiratat dhe ëndrrat e tyre dhe vizionin për të ardhshmen e komuniteteve rurale. Debati i të rinjve fokusohet në eksplorimin e arsyeve të migrimit të të rinjve nga zonat rurale, duke ngritur problematikat e hasura që i bëjnë të largohen nga zonat rurale. Dilema e të rinjve për të qëndruar apo për t'u larguar nga fshati, sfidat dhe modelet e sukseshme e të rinjve ruralë, zgjedhja e rrugës më të mirë për të ndjekur, si dhe elementët që duhet të ndryshohen dhe përmirësohen në zonat rurale për të krijuar një ambient insipirues për të ardhmen e të rinjve, ishin tematikat që dominuan debatin e të rinjve në Parlamentin e dytë Rural Shqiptar.

Nga Qendra Burimore e të rinjve rurale (ANRD Rural Youth Hub):

- Gent Imeraj
- Esmeralda Metko
- Labinot Murrja
- Safete Qato
- Ardit Frroku

Nga Universiteti Bujqësor i Tiranës:

- Armela Duka
 - Anxhela Morina
 - Fabio Hithi
 - Majkell Jajaj
 - Melisa Rrapaj
-

Pjesë nga fjala e të rinjve në sesionin plenar

Esmeralda Metko

Unë quhem Esmeralda, vij nga një fshat i rrethit të Përmetit. Jam maturante në gjimnazin “Sami Frashëri” në Përmet. Ndryshe nga të tjerët, më duhet të çohem herët në mëngjes, të marr furgonin dhe të shkoj në shkollë në qytet sepse fshati ku unë banoj nuk ka institucion arsimor. Madje edhe kur jam sëmurë duhet të shkoj në qytet sepse është e pamundur të shkosh në një qendër shëndetësore ku nuk ekzistojnë shtretërit për t’u vizituar, nuk ekzistojnë medikamentet, sistemi i ngrohjes, higjena.... Është e pamundur të hedhësh hapat drejt një godine që quhet qendër shëndetësore, por nuk kryen funksionin e saj. E sa e sa qendra të tilla shëndetësore ka në gjithë fshatrat e Shqipërisë, e sa e sa qendra shëndetësore vuajnë për mjekë e infermierë...

A jetojmë dot pa arsim dhe shëndetësi?

Jo nuk jetojmë dot në këto kushte Sepse mua më duhet të shërohem kur jam sëmurë, jo të lutem për jetën time. Sepse mua më duhet të arsimohem, sepse edhe unë që jetoj në fshat dua të rris vlerat e mia qytetare dhe të shkollohem në rrugën e dijes. Ndoshta një ditë kur këto dy sektorë të kenë marrë një formë, të jenë rregulluar, të jenë sistemuar unë do të kthehem në fshat dhe të jetoj aty. Por në këto kushte, duke marrë parasysh dhe çdo vështirësi që fshati ofron unë zgjedh të largohem nga fshati.

Gent Imeraj

Mbi të ardhmen | Fshatrat smart nëpër botë

Fshatrat SMART asht rendi i ri botror. Hendeku digjital fshat-qytet, tashma i ngushtuem n’vende t’ndryshme t’bots, e gjen Shqipnin me territore si përtej izolimit gjeografik, ndodhen “jashtë radarit”! Ndërkoh si vazhdoj udhrrëfimin n’për shtigje, ndalohem dhe mendohem për një t’met shumë t’pafalshme, ku ka zona, shtigje, stane që nuk dalin as n’hart virtuale, tuj përjashtu

ekzistenca, si për moralin digjital modern, nuk falet. Terrene t'harrume prej teknologjis, ku nuk jan ba regjistrime me GPS, përditsime n'sisteme informative gjeografike. Njeriu nuk e gjen shpin e vet n'hart! Punsimi n'koh pandemiet prej shtëpis ka me ken ndoshta rendi i ri botror. Por me cfar asht realitet, njeriu stoik i fshatit duket se nuk e ka mundsin me zgjedh, dhe kshtu mbetet i pa integrum n'punsim prej kushteve n'fshat. At'her, a nuk e kan fshtrat ton dëshiren me ken SMART? Jo vetëm dëshir, por mbajn n'brendsi tyne njerz puntor, t'mpreht e me vullnet t'hekurt si cdo dit i prek sedra si nuk u mundsohen kushtet me ken pjes e rrugtimit dixhital. Dhe zgjidhja duket t'jet: largohu prej fshatit, edukohu n'form autodidakte nëpër vende t'bots se cfar asht tu u ba, dhe rikthehu ma von me ia nis si shpeshher, prej posht mu u ngrit nelt. Utopike mduket besimi i teprum n'forc t'zakonit, po ma shpesh ka ken bekim nëpër histori se kërcnim.

Labinot Murrja

Unë jam nga Dibra e malit të Korabit, liqeneve të Lurës dhe lumit Drin, banues në fshatin Hotesht të Luznisë. Endërra për të jetuar në fshat, çdo ditë që vjen po më venitet duke menduar ose të banoj në qytet ose të shkoj në emigrim. Nuk jam vetëm unë që mendoj kështu. E përse mendoj kështu e jo ndryshe?....se akoma sot e kësaj dite një numri të madh fermerësh u mungon çertifikata e pronësisë së tokës, banesës dhe stallës së bagëtive, në një kohë kur kemi 30 vjet që merremi me reformën e tokës dhe mbi 100 vjet që kemi po këtë banesë e stallë blegtorie....se me reformën territoriale shërbimet u përqëndruan në qytet..për të therur një kafshë duhet të vihet nga Lura në Peshkopi...se Dibra sot e kësaj dite, nuk ka një treg të prodhimeve bujqësore; dhe 13.000 banorë të Maqellarës nuk ka as ujë për të pirë e as ujë për të vaditur.

Safete Qato

Kam shumë peshë ndër vete kur sa herë largohem nga fshati im drejt vendit në të cilin studioj... Të jesh i ri sot ka shumë sfida, dhe e vërteta është që i riu rural midis pëballjes me shumë probleme teknike, ekonomike dhe gjeografike ka edhe ato qëndrime, mendime të komunitetit që sado nuk e mbysin, frymëmarrjen ia pengojnë. Zhvillimet e shumta kanë lehtësuar jetën e fshatarit, por mentaliteti është i vështirë të ndryshohet sa vjen edhe më tepër. Një fëmijë rritet në fshat nën një mjedis të pastër por shumë konservator. Fshati është padyshim vendi ku krijohen stereotipet më të zakonshme ndoshta edhe më të rrezikshmet të shoqërisë.

...Që të vegjël djemtë rriten me idenë e “burrit” dhe favorizimi që u bëhet

e bën vajzën tepër inferiore, të ndrydhur dhe thua jse pa asnjë shpresë për ëndrra dhe realizime. Tani të vijmë tek arsimimi dhe ndërveprimi i te rinjve...nuk dinë se ç'është një e dalë pasditeve për argëtim, një festim apo dhe mbledhje për diskutime mbi tema të ndryshme. Duket se socializimi qendron me kilometra larg.....

Unë do të largohem, kjo për mua është zgjidhje, zgjidhje që do të zgjasë për aq kohë sa çdo i ri rural nuk do të jetë i lirë të shohë përtej “maleve dhe kodrave” që e rrethojnë.

Reagime dhe konkluzione nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme

Alban Ibraliu, Zv Rektor për Marrëdhëniet me Institucionet dhe Publikun, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Fillimisht z.Ibraliu e konsideroi një histori suksesi bashkëpunimin me donatorët gjermanë për hapjen e një programi doktrature midis UBT dhe universiteteve më të mira bujqësore të Gjermanisë për rreth njëzet studentë ekselentë të UBT-së. Më pas z.Ibraliu u ndal në çështjen e produktivitetit të ulët të faktorëve të prodhimit në realitetin rural shqiptar pa harruar të përmendë edhe disa histori suksesi të lidhura me prodhimin intensiv në mjediset e mbrojtura (sera), sipërmarrjet e bimëve mjekësore, agrumet etj. Gjithashtu zv Rektori përmendi si alternativë shumë produktive në zonat rurale, fermat e agroturizmit si edhe ato blegtorale të cilat kanë shënuar zhvillim të dukshëm kohët e fundit duke identifikuar si çelës të zhvillimit rural rritjen e faktorit punë. Për rritjen e këtij faktori, ai nënvizoi rëndësinë e mbështetjes së fermave intensive e të qëndrueshme me histori të konsoliduar në treg dhe me produktivitet të lartë.

Duke iu referuar lidhjes së UBT-së me zhvillimin bujqësor dhe rural dhe përgatitjen e specialistëve të rinj në shërbim të tij, z. Ibraliu nënvizoi rëndësinë e interesit për degët tradicionale të studimit në këtë universitet. Në këtë kontekst, ai u tërhoqi vëmendjen të rinjve (sidomos maturantëve në pritje të përzgjedhjes së degëve universitare) mbi faktin që profesionet që lidhen

me zhvillimin bujqësor dhe rural nuk do të dalin asnjëherë jashtë mode prandaj ka rëndësi konsiderimi i tyre nën një këndvështrim të ri. Duke sjellë shembullin e QTTB-ve dhe dhe pajisjes së tyre me staf teknik, z.Ibraliu vuri në dukje mungesën e aplikantëve nga zonat rurale në proceset e rekrutimit për shkak të mospjesëmarrjes së tyre në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve universitare në degët tradicionale të përmendura më sipër. Po e njëjta problematikë lidhet edhe me shërbimin e ekstensionit bujqësor si edhe bizneset bujqësore e rurale dhe nevojat e tyre për specialistë, të cilat duhet të plotësohen.

“Në vitet e fundit interesi i të rinjve për profesionet dhe degët tradicionale në UBT është zbehur. E kam fjalën për agronominë, zooteknikën, shkencën e pyjeve. Dua të ftoj të rinjtë që të kenë një qasje të re në lidhje me këto profesione që edhe pse tradicionale, janë dhe mbeten pjesë e të tashmes dhe të ardhmes së zhvillimit bujqësor dhe rural në vendin tonë e më gjerë”.

Në vijim, z.Ibraliu evidentoi nevojën për politika më të mira mbështetëse në lidhje me rritjen e aksesit të të rinjve ruralë në degët tradicionale universitare që furnizojnë tregun dhe institucionet e linjës me specialistë të zhvillimit bujqësor dhe rural, duke nënvizuar këtu rolin mbështetës të donatorëve të huaj me programe dhe projekte specifike.

Kleina Kasanai, Drejtoreshë e Përgjithshme, Agjencia Kombëtare e Rinisë

Edhe pse nënvizoi mungesën e informacionit dhe njohurive të plota në lidhje me realitetin rural, zj Kasanai pranoi ekzistencën e problemeve të identifikuar gjatë debatit nga të rinjtë e zonave rurale duke e gjetur me vend të përmendte edhe arritjet e përmirësimit në fusha të ndryshme të jetës në fshat. Këtu Drejtorja e Agjensisë renditi ndryshimet pozitive në infrastrukturën fizike, punën e agropikave, skemat e rimbursimit të naftës për fermerët, mbështetjen e investimeve në zonat rurale përmes programit IPARD, rinovimin e infrastrukturës shëndetësore në zonat rurale, hartimin e projektligjit për startup-et, rritjen e mbështetjes së ideve novatore të të rinjve nga donatorët etj.

“Unë vura re që të rinjtë që janë këtu në panel janë shumë të përgatitur, dhe dua të mbetem shpresëplotë që të rinj të përgatitur ka dhe përtej këtyre mureve. Jam e bindur që ka të rinj që kanë marrë një shkollim të mire dhe mund të bëjnë kërkime e hulumtime shumë të mira. Nisur nga kjo dua të them që është e rëndësishme që ju si të rinj të përgatitur dhe me vision jo vetëm të ngrini problematika, por edhe të kontribuoni me idet tuaja rreth mënyrës se si mund të përmirësojmë gjëndjen aktuale”.

Duke u ndalur më gjerësisht tek projektligji për startupet që është në finalizim e sipër, zj. Kasanai vlerësoi mundësitë që ky ligj ofron për të rinjtë që kanë ide novatore dhe dëshirojnë të futen në botën e sipërmarrjes nëpërmjet ofrimit të mbështetjes nga një Agjenci ku këto ide do të mbështeten nga donatorë të ndryshëm që shprehin interes në këtë fushë.

Në fund zj. Kasanai vlerësoi nivelin dhe përgatitjen e të rinjve ruralë dhe kapacitetet e tyre për të pasur arritje në fushën e kërkim zhvillimit, duke u kërkuar të ngrejnë zërin për problemet që i shqetësojnë duke ofruar edhe zgjidhje me pjesëmarrje për to.

Sofjola Kotelli, Këshilltare, projekti SRD Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ).

Zj. Kotelli vlerësoi angazhimin e të rinjve në bujqësi si çelësi për zhvillimin e zonave rurale duke u bërë thirrje aktorëve qendrorë, atyre nga shoqëria civile dhe academia të përqafojnë këtë qasje. Duke iu referuar shifrave, ajo vuri në dukje se më shumë se gjysma e të rinjve në zonat rurale mendojnë që të emigrojnë. Po kështu vetëm 14.2% të të rinjve që mbarojnë shkollat profesionale bujqësore preferojnë të qendrojnë në fshat. Të dhënat tregojnë se vetëm 10% e studentëve të Universitetit Bujqësor të Tiranës kanë zgjedhur si preferencë të parë të studiojnë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, duke treguar interesin e ulët të të rinjtve për t'u angazhuar në këto fusha.

Ndërkohë nga ana tjetër sipas burimeve të AZHBR, sipërmarrja e të rinjve në fushën e bujqësisë është rritur me mbi 40%, sidomos nga të rinjtë e moshës 18-40 vjeç, çfarë tregon qartë se bujqësia ofron potencial për t'i angazhuar ata. Duke iu referuar debatit të të rinjve, zj. Kotelli mbështeti idenë e ndryshimit të mënyrës së të menduarit rreth fshatit. Ajo u përqendrua tek iniciativat e fundit të projektit të SRD/GIZ në lidhje me zhvillimin rural ku përmendi fushatën Agricoool. Kjo fushatë është emërtuar kështu për t'u treguar të gjithë të rinjve anë e mbanë vendit që sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural është po aq cool (tërheqës e modern) sa të gjithë sektorët e tjerë dhe ka shumë mundësi për angazhimin e tyre në këtë sektor. Ajo sqaroi dy linjat kryesore të fushatës: linja promovuese e bujqësisë si një aktivitet tërheqës dhe me përfitim për të rinjtë dhe linja e projekteve konkrete për mbështetjen e aktiviteteve bujqësore. Në këtë kuadër, këshilltarja e GIZ informoi të pranishmit rreth paketës së projekteve konkrete, duke përmendur trajnimin e rreth 350 të rinjve ruralë nga e gjithë Shqipëria gjatë viteve 2019-2020 me fokus krijimin e një perspektive në lidhje me angazhimin e tyre në aktivitetet bujqësore. Gjithashtu, zj. Kotelli informoi rreth përgatitjes së një pakete të re trajnimit në vendin e punës

për të rinjtë, e bazuar kjo në studime mbi nevojat e bizneseve, e cila do të lançohet gjatë vitit 2021.

“Më bëri shumë përshtypje gjatë Parlamentit ideja e hedhur nga një prej debatuesëve:- Të ndryshosh realitetin do të thotë të ndryshosh mentalitetin! – kjo është ajo që GIZ po inicion nëpërmjet fushatës Agricoool. Fushata synon që të rinjtë të kuptojnë që bujqësia është po aq cool (në modë) sa edhe të gjitha degët e tjera të ekonomisë dhe ja vlen dhe është produktive që të rinjtë të merren me të!”

Një komponent tjetër i paketës është bashkëpunimi me gjashtë shkolla profesionale dhe forcimi i lidhjes së të rinjve me fermerët e zonës duke aplikuar në praktikë njohuritë e mara dhe të rejat e shkencës dhe teknikës bujqësore. Githashtu, parashikohet përshtatja e kurrikulave të shkollave bujqësore me nevojat e tregut si edhe futja e elementëve të digjitalizimit dhe teknologjive të përparuara bujqësore. Përsa i përket arsimit të lartë, parashikohet hapja e një programi doktorature midis UBT-së dhe universiteteve më të mira bujqësore të Gjermanisë për studentët ekselentë që kanë mbaruar UBT.

Zj.Kotelli u ndal edhe tek paketa e promovimit të sipërmarrjes bujqësore dhe rurale. Ajo prezantoi mbështetjen e dedikuar që GIZ ofron nëpërmjet programit IDEA dhe atij për Inovacionin dhe CoSolve për sipërmarrësit në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural duke inkurajuar veçanërisht nismat për digjitalizimin e bujqësisë.

Alberto Sartori, Menaxher i projektit Rural-You. Rural Albanian Youth, RTM Volontari nel Mondo

Z. Sartori prezantoi projektin Rural-You. Rural Albanian Youth, një projekt 32 mujor i financuar nga Bashkimi Evropian që po zbatohet në zonat e Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës (11 bashki), nga konsorciumi i gjashtë organizatave nën lidhshin e Volontari Nel Mondo RTM. Organizatat partnere janë: Partnership for Development Foundation – PFD, Agropuka, Associazione Giovani Imprenditori Agricoli (AGIA) of Confederazione Italiana Agricoltori (CIA) dhe Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural.

Ai nënvizoi se projekti Rural-You. Rural Albanian Youth ka si objektiv të nxisë interesin, përfaqësimin dhe kontributin e të rinjve ruralë në zbatimin e axhendës së anëtarësimit të Shqipërisë në BE në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Më konkretisht, projekti synon të përmirësojë pjesëmarrjen e të rinjve në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike të komuniteteve të thella rurale në Shqipërinë verilindore përkatësisht në rajonet e Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës.

“Projekti është një ftesë për të parë botën rurale nga perspektiva e të rinjve, duke u mundësuar të rinjve ruralë të jenë të vetëdijshëm për mundësitë e sektorit, të marrin pjesë në mënyrë aktive në rritjen e qëndrueshme të zonave të tyre dhe të jenë aktivë në politikbërje”.

Më pas ai shpjegoi se ndërhyrja synon të forcojë kapacitetet e të rinjve, aktivistëve, dhe OShC-ve lokale për të monitoruar, analizuar dhe ndërmarrë veprime konkrete përmes një qasje integrale, duke u siguruar grupeve të synuara jo vetëm zhvillimin e kapaciteteve por edhe përvojën advokuese për të kontribuar në zhvillimin e sektorit përmes përfshirjes në politikat rurale.

Strategjia e ndërhyrjes bazohet në tre grupet kryesore të aktiviteteve që reflektohet në produktet kryesore të projektit: ndërgjegjësimin mbi rolin e të rinjve në reformën bujqësore dhe rurale në Shqipëri, aktivizimin e të rinjve në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale si edhe rrjetëzimin përmes konsolidimit të Qendrës Burimore të të Rinjve Ruralë – Rural Youth Hub si një përvojë pilote për të angazhuar të rinjtë që jetojnë në zonat e largëta në veprime rrjetëzuese të lidhura me dialogun e politikave.

Amadeo Kola, Mësues, Shkolla e Mesme Profesionale “Ndre Mjeda”.

Mësuesi i shkollës së mesme profesionale thekson rolin që ka arsimiti i lartë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural në përmirësimin e kontributit të të rinjve në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Kjo për faktin që bujqësia është dhe do të mbetet një sektor prioritar për Shqipërinë, si dhe nisur nga fakti që numri i studentëve që studiojnë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural është i ulët, krijohet përparësi për këta të rinj të ushtrojnë profesionin e tyre duke kontribuar në rivitalizimin e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

z. Kola ndan shqetësimin se institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional nuk mund t'i përgjigjen në mënyrë të kënaqshme pyetjeve themelore: sa, ku dhe si. Më konkretisht, disa nga pyetjet më thelbësore që ai shtron janë :

- A arrijnë të rinjtë të sigurojnë aftësitë e nevojshme për tregun e punës në përshtatje me interesat e tyre për të nxënë gjatë gjithë jetës, për të ecur në një hap me risitë teknologjike me të cilat do të ndeshet në punë?
- Po në lidhje me njohuritë, aftësitë e shprehite e përgjithshme e të larmishme profesionale, që lehtësojnë punësimin?
- A munden të rinjtë të garantojnë mirëqenie ekonomike për vete dhe

- familjen përmes integritit në tregun e punës?
- A mundet rinia të përballet me sfidat aktuale dhe të ardhshme globale?

Z. Kola ndër të tjera ofron edhe rekomandime drejtuar kryesisht kolegeve të vet dhe gjithë stafit mësimor.

“Për t’i shtuar vlerë rezultatit të punës sonë duhet të fokusohemi në nxitjen e disa elementëve të rëndësishëm si interesimi i të rinjve në lidhje me mirëqënien, kulturën, turizmin, bujqësinë dhe sigurinë ushqimore. Një tjetër element i rëndësishëm është mbështetja e qeverisë dhe promovimi i arsimit profesional duke ndikuar në zhvillimin e personalitetit të të rinjve për të jetuar në përshtatje me kushtet që i rrethon. Promovimi i të rinjve dhe subvencionimi i bizneseve bujqësore duke lehtësuar procedurat për grante janë faktorë që kanë impakt të rëndësishëm në rivitalizimin e sektorit”
përfundoi ndërhyrjen e tij z. Kola.

SESSION PËRMBYLLËS Leximi i Deklaratës së Parlamentit të Dytë Rural Shqiptar 2021

DEKLARATË E PARLAMENTIT TË DYTË RURAL SHQIPTAR

PERSPEKTIVA EVROPIANE E SHQIPËRISË RURALE

4-5 mars 2021

Ne, mbi 600 pjesëmarrës nga e gjithë Shqipëria, u mbledhëm virtualisht dhe fizikisht në Parlamentin e dytë Rural Shqiptar më 4-5 mars, organizuar nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural në koordinim me Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Universitetin Epoka dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve publike, autoriteteve vendore, fermerëve, organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë në nivel vendor. Pavarësisht vështirësive të krijuara nga pandemia Covid-19, Parlamenti i dytë Rural Shqiptar, nëpërmjet platformës digjitale dhe falë përpjekjeve organizative dhe koordinuese të Rrjetit Shqiptar për Zhvillim Rural, bëri të mundur realizimin e këtij takimi të rëndësishëm për dialog, bashkëpunim, shkëmbim dhe diskutim të çështjeve me rëndësi për zhvillimin rural si dhe për të ofruar rekomandime për zhvillimin dhe rigjallërimin e jetës dhe ekonomisë së komuniteteve rurale.

Kjo Deklaratë mbështetet në kontributin e dhënë nga pjesëmarrësit gjatë zhvillimit të seancave të Parlamentit Rural si dhe në forumet rurale rajonale të organizuara gjatë vitit 2020. Parlamenti dhe forumet rajonale krijuan hapësira diskutimi dhe konsultimi duke mundur kështu forma të tjera për marrjen e kontributeve nga aktorë të ndryshëm. Ky ka qenë një moment i rëndësishëm për të shqyrtuar realitetin dhe për t'u njohur më mirë me nevojat dhe problematikat, për të reflektuar rreth vizionit dhe prioritetëve që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve rurale në vend. Ne i bëjmë thirrje Qeverisë, Parlamentit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Njësive të Vetë-qeverisjes Vendore, Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural si dhe aktorëve të tjerë publikë dhe privatë, përfshirë këtu akademinë, organizatat e shoqërisë civile, biznesin e të tjerë, të investojnë për rigjallërimin e jetës dhe ekonomisë së komuniteteve rurale duke marrë parasysh edhe përparësitë dhe rekomandimet e dhëna në këtë Deklaratë.

Pyetësi i realizuar në kuadër të forumeve rurale rajonale ndihmoi në përcaktimin e tre elementëve të zinxhirit të vlerës sipas shkallës së ngutshmërisë që ato kanë për mbështetje me politika publike. Mbështetja financiare (mbështetja direkte me grante e pagesa) u vlerësua shumë e rëndësishme nga 77% e pjesëmarrësve të pyetësorit; burimet njerëzore (trajnimi dhe nxitja e të rinjve dhe grave) u vlerësua shumë e rëndësishme nga 50% e pjesëmarrësve; dhe infrastruktura publike vendore (ujësjellësi, rrugët, energjia elektrike, tregjet, infrastruktura e grumbullimit të produkteve bujqësore, etj.) u vlerësua nga 42% e pjesëmarrësve.

Skemat kombëtare të mbështetjes së bujqësisë dhe zhvillimit rural

Skemat kombëtare janë një instrument i rëndësishëm për mbështetjen e bujqësisë dhe zonave rurale në përgjithësi. Ne theksojmë rëndësinë jetike të institucionalizimit të hartimit të skemave të mbështetjes me pjesëmarrjen e fermerëve dhe grupeve të tjera të interesit. Marrja e mendimit dhe shqyrtimi i prioriteteve të fermerëve në procesin e hartimit të skemave kombëtare duhet të kthehet në një praktikë të rregullt institucionale. Hartimi i një kalendari të detajuar dhe i parimeve bazë të dialogut duhet të bëhet në përputhje me rregullat dhe procedurat për njoftimin dhe konsultimin publik.

Ndryshimi i shpeshtë apo i përvitshëm i skemave nuk mundëson orientim dhe qëndrueshmëri për fermerët dhe aktorët e tjerë të zhvillimit bujqësor dhe rural. Për këtë arsye sugjerojmë krijimin e skemave mbështetëse të pandryshueshme për një afat 3 deri në 5 vjet. Është e nevojshme që në funksion të nxitjes së zhvillimit koheziv dhe të balancuar të territoreve vendore duhet të aplikohet efekti i ekualizimit të fondeve, duke diferencuar masat dhe fondet sipas rajoneve, qasje e cila kombinohet me hartën e produkteve bujqësore.

Kërkojmë që të përmirësohet transparenca duke dixhitalizuar të gjithë procesin, nga aplikimi, përzgjedhja deri te pagesat për fermerët.

Këmbëngulim në rritjen e mbështetjes buxhetore në 4 vitet e ardhme me të paktën 3 herë më shumë krahasuar me vitin 2020 dhe të pagesave direkte me të paktën 4 herë më shumë për të përmbushur nevojat aktuale të fermerëve për mbështetje dhe për t'u përafëruar me vendet në rajon.

Zonat rurale të largëta dhe malore

Zhvillimi rural i referohet procesit të përmirësimit të cilësisë së jetës dhe mirëqenies ekonomike të njerëzve që jetojnë në zona relativisht të izoluar dhe pak të populluara.

Bëjmë thirrje për formulimin dhe zbatimin e një politike nxitëse dhe stimuluese për mbështetjen e zonave rurale të largëta dhe malore nëpërmjet: a) përcaktimit të përkufizimit të qartë të zonave rurale dhe të zonave më pak të favorizuara në nivelin e njësive administrative; b) favorizimit me pikë shtesë në skemën kombëtare për fermerët e këtyre zonave dhe c) krijimit të masave specifike në lidhje me grumbullimin, përpunimin dhe kultivimin e frutave të pyllit dhe bimëve mjekësore për grumbulluesit dhe përpunuesit e licencuar të zonës me kushtin që të punësojnë banorë nga këto zona.

Fermerët e vegjël

Zhvillimi rural i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës përfaqëson alternativën e zhvillimit që fuqizon dhe integron fermerët e vegjël dhe ekonominë bujqësore familjare. Problematika dhe sfidat me të cilat përballen fermerët e vegjël janë mjaft specifike dhe shpesh të patrajtuara dhe të papërfaqësuara në debatin që zhvillohet për hartimin e politikave për zhvillimin rural. Kjo Deklaratë është e lidhur ngushtë me përfaqësimin e problematikave të zhvillimit të hasura nga fermerët e vegjël në mbarë Shqipërinë dhe për t'i sjellë ato në vëmendjen e politikëbërjes.

Reforma më e madhe e fshatit e nxitur nga Ligji Nr. 7501, “Për Tokën”, mban ende peng shumë ekonomi bujqësore në formalizimin e pronës. Fermerët, në veçanti fermerët e vegjël, vazhdojnë të përballen me vështirësi ekonomike dhe perspektivat e tyre për zhvillim duket se janë duke u zvogëluar. Përqindja e lartë e fermerëve të vegjël dhe problemet me të cilat përballen në mënyrë evidente kërkojnë formulimin e një politike kombëtare për të mbështetur forcimin e SHBB-ve dhe nismat e zinxhirit të shkurtër të vlerës.

Për këtë, ne nxisim Qeverinë, komunitetin e donatorëve dhe organizatat e shoqërisë civile që të angazhohen në nisma konkrete për zinxhirin e shkurtër të vlerës duke ndihmuar krijimin e kooperativave, shoqatave të bashkëpunimit dhe zinxhirit të shkurtër të furnizimit.

Ne i bëjmë thirrje Qeverisë që të krijojë lehtësira fiskale për t'i dhënë shtysë krijimit të SHBB-ve të reja dhe forcimit dhe rritjes së SHBB ekzistuese. Ne sugjerojmë krijimin e një pjese buxhetore të caktuar (minimalisht 35%) në pagesat direkte për fermerët e vegjël me qëllim për të rritur përkatësinë e mbështetjes buxhetore për fermerët e vegjël e për t'i dhënë mundësi të barabarta dhe të drejta të suksesshmërisë nisur nga kushtet jo të krahasueshme me pjesën tjetër të ekonomive bujqësore. Në funksion të kësaj lind nevoja e përkufizimit të fermës së vogël.

Të rinjtë

Të rinjtë janë të rëndësishëm për vazhdimësinë e jetës në zonat rurale, për bujqësinë si dhe për sigurinë ushqimore. Megjithatë, të rinjtë janë të papërfaqësuar në strukturën e ekonomisë agrare. Vetëm 1% e drejtuesve të ekonomive bujqësore janë të moshës deri 25 vjeç. Studimet tregojnë se në ekonomitë bujqësore, rritja e moshës mesatare, migrimi si dhe mungesa e programeve trajnuese kanë sjellë uljen e ndjeshme të kapitalit njerëzor. Aktualisht, mundësitë e të rinjve për t'u shkolluar apo trajnuar në bujqësi konsiderohen të pakta.

Përmirësimi i cilësisë së jetesës në zonat rurale ka gjasa ta bëjë fshatin tërheqës për të rinjtë për të qëndruar. I bëjmë thirrje të gjithë aktorëve zhvillimorë të punojnë me të rinjtë me qëllim që të rrisin tek ata dëshirën për të kontribuar për vendin e vet nëpërmjet trajnimeve, mundësive për punësim dhe vetëpunësim dhe trajnimit në vendin e punës. Është me rëndësi të gjenden mekanizmat dhe stimujt e duhur për të rritur interesin e të rinjve për formim në shkollat e mesme profesionale. Gjithashtu, ngjashmërisht me Politikën e Përbashkët Bujqësore të BE-së 2021-2027 sugjerojmë të hartohet një masë e veçantë mbështetje për sipërmarrjet bujqësore të nisura nga fermerë të rinj (nën moshën 39 vjeç).

Gratë dhe vajzat rurale

Ngjashëm si të rinjtë në zonat rurale, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përmirësimit të statusit social ekonomik të grave dhe vajzave rurale. Të ndërjegjeshëm se zhvillimi i qëndrueshëm social dhe ekonomik i vendit nuk mund të arrihet nëse nuk u ofrohet mbështetje grave dhe vajzave në zonat rurale që të luftojnë varfërinë dhe përjashtimin social, këmbëngulim se përfshirja e fuqizimit social-ekonomik të tyre në agjendën e politikë-bërjes së sektorit është prioritet.

Sugjerojmë ridimensionimin e skemës së mbështetjes së bujqësisë duke brendësuar çështjet gjinore në procesin e aplikimit me qëllim të ngushtimit të hendekut social dhe ekonomik. Kjo kërkon një rishikim tërësor të procesit të aplikimit për të tejkaluar mangësitë dhe garantuar drejtësinë e procesit.

Jetësimi i Qasjes Leader në komunitetet rurale shqiptare

Zhvillimi Vendor i udhëhequr nga Komuniteti (CLLD) si një formë e re e zhvillimit të zonave rurale dhe të demokracisë me pjesëmarrje, respektimi i parimit të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit si dhe qasja LEADER qëndrojnë në bazë të këtij procesi gjithëpërfshirës me orientim nga poshtë

lant. Ndonëse përpjekjet për zbatimin e qasjes LEADER në vendin tonë janë relativisht të hershme edhe pse të pashoqëruara me mbështetje të qëndrueshme në kohë, veçoritë e zhvillimit të përgjithshëm socio-ekonomik të vendit e evidentojnë atë si faktor thelbësor në përmirësimin e jetesës së komuniteteve rurale, në zbutjen e varfërisë, reduktimin e pabarazive gjinore e territoriale si dhe forcimin e kapitalit social dhe demokracisë vendore.

Ne kërkjmë vullnet politik për ta mbështetur dhe priorizuar këtë instrument të politikës së zhvillimit rural si dhe për të përsheptuar zbatimin efektiv të tij si një faktor thelbësor në përmirësimin e jetesës së komuniteteve rurale shqiptare, veçanërisht në ndalimin e shpopullimit dhe braktisjes së tyre. Sugjerojmë të investohet në rolin e agjentit të zhvillimit lokal. Ky agjent punon për të ngritur besimin tek vlerat e vendit, identiteti, tradita, kultura, mjedisi, elemente të cilët rritin dëshirën të jetosh aty dhe të mos e braktisësh fshatin.

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural, inovacioni dhe transferimi i njohurive në bujqësi dhe zhvillim rural

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural është dhe duhet të konsiderohet nga MBZHR një nga aktorët kryesorë në lidhje me promovimin e inovacionit dhe transferimit të njohurive në bujqësi dhe zhvillimin rural veçanërisht në tre fusha kryesore si: inovacioni në sipërmarrjen bujqësore, inovacioni ekologjik dhe inovacioni social i cili synon të forcojë kapacitetet dhe burimet njerëzore në zonat rurale, veçanërisht duke përfshirë të rinjtë dhe gratë. Fondet nën masën e Asistencës Teknike të programit IPARD dhe të buxhetit kombëtar përmes skemave të AZHBR-së do të krijojnë instrumentet e duhura financiare për të adresuar inovacionin në bujqësi dhe zonat rurale.

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural fton dhe institucionet e tjera si Ministria e Arsimit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mjedisit dhe Turizmit të ndajnë më shumë fonde për institucionet përkatëse nën përgjegjësinë e tyre të tilla si: Universiteti Bujqësor, Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, shkollat e arsimit profesional, subjektet e tjera kërkimore që mund dhe duhet të sigurojnë kontribut në rritjen e rolit të arsimit dhe kërkimit në lidhje me inovacionin në bujqësi. Në këtë mënyrë ato kontribuojnë në përmirësimin e të ardhurave dhe mirëqenies së fermerëve dhe njerëzve në zonat rurale si dhe ndikojnë në vendimet e tyre për të qëndruar aty, për të bërë biznes dhe për të mos i braktisur ato.

Ne i bëjmë thirrje Kuvendit të Shqipërisë, Qeverisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Njësive të Vetë-qeverisjes Vendore dhe institucioneve të tjera vendimmarrëse që ta shohin këtë Deklaratë si një dokument që vë theksin në disa prej çështjeve prioritare dhe aspak shteruese.

Ndërkohë, deklarojmë se do të vazhdojmë angazhimin tonë për monitorim të vazhdueshëm të politikave dhe proceseve, ngritje kapacitetesh, rrjetëzim dhe advokaci për zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve rurale. Rrjeti Kombëtar për Zhvillimin Rural mbetet i gatshëm që së bashku me anëtarët dhe partnerët të kontribuojë për zbutjen dhe zgjidhjen e problemeve të komuniteteve vendore.